

# Libër rrëfyes

për

Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB për Gratë, Paqë  
dhe Siguri për njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe komisionet për  
mundësi të barabarta

**Autorë:**

Afërdita Haxhijaha Imeri dhe Daniela Dimitrievska

Shkup, 2016

**Botues:**

Lobi i grave të Maqedonisë

**Autorë:**

Aferdita Haxhijaha Imeri  
Daniela Dimitrievska

**Përkthim:**

Flora Krifca

**Dizajn dhe kopertinë:**

Media Konekt

**Rregullim grafik dhe shtyp:**

Media Konekt

# Libër rrëfyes

për

Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB për Gratë, Paqë  
dhe Siguri për njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe komisionet për  
mundësi të barabarta

**Disclaimer**

Ambasada Britanike në Shkup mbështeti përgatitjen e këtij publikimi, brenda projektit “Fuqizimi i grave dhe vajzave për paqëruajtje të ngritur dhe ndërtim të besimit”. Përmbajtja e këtij botimi nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin apo mendimet e Ambasadës Britanike në Shkup.



British Embassy  
Skopje

## Përmbajtje

---

<b>I. Prapavija dhe qëllimi:</b>	<b>1</b>
<b>II. Rëndësia e Rezolutës 1325 të KSOKB në shoqërinë bashkëkohore dhe si ka ndryshuar natyra e konfliktit dhe paqes</b>	<b>3</b>
<b>III. Histori e shkurtë e Agjendës për grate, paqe dhe siguri në kontekst ndërkombëtar dhe në Republikën e Maqedonisë</b>	<b>7</b>
1. Gratë, paqja dhe siguria dhe agjenda zhvillimore në Maqedoni	9
2. Reforma në sektorin e sigurisë në vend	11
<b>IV. Prezantimi i Planit nacional për veprim të Republikës së Maqedonisë për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurisë të OKB</b>	<b>13</b>
1. Sfidat në zbatimin e PNV	18
2. Vendosja legjislative dhe institucionale dhe palët e përfshirë	19
<b>V. Rëndësia e Rezolutës 1325 të KS të OKB për Republikën e Maqedonisë nëpër thjerrëzat e dialogut dhe tolerancës ndëretnike</b>	<b>27</b>
1. Korniza institucionale e marrëdhënieve ndëretnike	30
2. Sfidat e lidhura me dialogun ndër-etnik (si parakusht për paqe dhe stabilitet) në vend	31
<b>VI. Njësitë e Vetëqeverisje Lokale dhe lidhja mes barazi gjinore, kohezionit dhe mekanizmat e sigurisë publike ndëretnike</b>	<b>33</b>
<b>VII. Gratë refugjate në Maqedoni dhe sfidat që duhet të adresohen nga Rezoluta 1325</b>	<b>41</b>

<b>VIII. Praktikët e mira në zbatimin e Rezolutës 1325 nga vendet në rajonin e Ballkanit dhe në Evropë.</b>	<b>51</b>
1. Zbatimi i Rezolutës 1325 në Bashkimin Evropian	51
2. Plani Kombëtar i veprimit i Irlandës për zbatimin e Rezolutës 1325	52
3. Plani i Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 i Bosnjës dhe Hercegovinës	55
<b>Bibliografia dhe Referencat</b>	<b>60</b>
<b>Aneks 2 Plani nacional për veprim i Republikës së Maqedonisë 2013-2015 për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurisë së OKB.</b>	<b>62</b>

## I. Prapavija dhe qëllimi:

Sa i përket perspektivës së barazisë së grave dhe gjinore, Rezoluta 1325 e KS të KB paraqet një ndër rezolutat më të rëndësishme të KB në fushën e politikës paqësore dhe të sigurisë. Ajo përmban udhëzime për parandalimin e konflikteve të armatosura, pjesëmarrjen e grave në të gjitha nivelet e procesit të politikave paqësore dhe të sigurisë, mbrojtjen e grave dhe fëmijëve femra në situata lufte dhe pas konflikteve, veçanërisht mbrojtjen e tyre nga dhuna seksuale dhe keqtrajtimi, të cilët shpesh janë pjesë e strategjisë së konflikteve të armatosura.

Ashtu siç është rast edhe në pjesët tjera të botës, në Republikën e Maqedonisë Rezoluta siguroi kornizë kyçe ligjore dhe politike and ndikoi në palët e prekur të merren me përforcimin e pjesëmarrjes së grave në parandalimin, zgjidhjen e konflikteve, paqëruajtjen dhe ndërtimin e paqes, si dhe në sigurimin e mbrojtjes së tyre ligjore dhe fizike, duke u përqëndruar në shfrytëzimin e të gjitha mjeteve në dispozicion në parandalimin e konflikteve të armatosura. Pjesëmarrja e rritur e grave në të gjitha fushat është pjesë përbërëse e përpjekjeve për përforcim të mëtutjeshëm të paqes dhe sigurisë në vend dhe në rajonin e Ballkanit perëndimor.

Rezoluta hap një shteg të ri për gratë në rajon në sferën e mbajtjes dhe ndërtimit të paqes, gjë që është me rëndësi të veçantë sepse Republika e Maqedonisë kontribon në misionet e NATO në rajonet e prekura nga konflikte në botë.

Rritja në vazhdimësi e vuajtjeve të civilëve demonstroi urgjencën e respektimit të plotë të Rezolutës. Raportet, të dhënat dhe informatat tjera rreth natyrës së konflikteve të mëparshme dhe ekzistuese tregojnë se civilët më të prekur në konfliktet pas luftës së ftohtë kanë qenë gratë dhe fëmijët. Gratë kanë vuajtur dhe ende vuajnë vështirësitë e ngjashme, brutalitet dhe keqpërdorim në të gjitha zonat në konflikt dhe pas konfliktit.

Në anën tjetër, duhet të theksohet se keqpërdorimi i tmerrshëm i të drejtave të grave gjatë luftërave ka qenë e përcjellur me përkeqësimin e të drejtave të tyre ekonomike dhe sociale si pasojë e politikave të ashpërsuara (mbrojtja sociale, mbrojtja shëndetësore, kujdesi për fëmijët, papunësi) në krizën ekonomike dhe financiare ekzistuese. Ky erosion ka qenë i shoqëruar me rritjen e vlerave konzervative, tradicionale, por edhe fundamentaliste dhe religjioze të cilët nuk e favorizojnë gruan në jetën publike dhe politike. Ky trend anti-modernistik është prezent – edhe pse në mënyra të ndryshme – në të gjitha vendet ish-jugosllave, dhe është me theksuar në vendet rurale në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni dhe Serbi.

Në Republikën e Maqedonisë, gratë kanë arritur të promovohen, individualisht ose në grupe, si avokatë të fortë të paqes. Organizatat e grave kanë qenë në krye të luftës për mbrojtjen e të drejtave të grupeve të pafuqishme, siç janë refugjatët, minoritetet dhe gratë dhe vajzat.

Duke e pasur parasysh qeverinë dhe shoqërinë qytetare, dhe veçanërisht organizatat e grave e kanë njohur Rezolutën 1325 të KS të KB si dokument unik për paqe dhe siguri, e cila qëndron mbi të gjitha për pjesëmarrjen e plotë të grave në vendosjen dhe mbajtjen e paqes së qëndrueshme. Definimi i Rezolutës për dhunën kundrejt grave – veçanërisht keqtrajtimin seksual – si kërcënim për paqen dhe sigurinë prek një fundament të rëndësishëm për të gjitha gratë në vend dhe më gjërë në rajon. Në tërësi, Rezoluta ka luajtur rol kyç në kycjen e aspektit të gjinisë në politikat qeveritare në fushën e sigurisë. Kjo, gjithashtu ka dhënë shtytje për të ngritur nisma të vlefshme dhe për të avancuar procesin e ndryshimit të perceptimit të rolit të grave dhe vajzave në shoqëritë post-konflikte dhe tranzicionale.

Maqedonia ka adaptuar Plan nacional të veprimit në janar të vitit 2013 dhe pas tre viteve nga zbatimi, është koha për t'i vlerësuar arritjet e deritanishme dhe për të filluar zhvillimin e Planit të ri nacional, të bazuar në përvojat dhe mësimet e marra.

Duke e bërë një gjë të tillë, gjatë këtij libër-rrëfyesi, ne duam të kontribuojmë në ngritjen e mëturshme të vetëdijes për inkuadrimin e grave në Maqedoni në zbatimin e qëllimeve të Agjendës për gra, paqë dhe siguri, veçanërisht duke pasur parasysh mbajtjen e procesit të sigurimit të brendshëm stabil, dhe kështu duke kontribuar në kohezionin e shoqërisë dhe dialogut të mirëfilltë ndër-etnik.

Ky libër-rrëfyes demonstroi se ekziston një potencial i pashfrytëzuar brenda komuniteteve lokale dhe mekanizmave ekzistuese, potenciali i të cilëve nuk është shfrytëzuar plotësisht për qëllime të zbatimit të Planit nacional të veprimit, për Rezolutën 1325 të KS të KB.

Ne shpresojmë që ky libër-rrëfyes të shërben si burim për ngritjen e kapaciteteve të aktorëve në komunitetet lokale, siç janë administrata komunale, komisionet e Këshillit të vetëqeverisjes lokale, përfaqësuesit e organeve të sigurimit dhe shoqërive civile – organizatave qytetare të grave për mobilizimin dhe veprimin e tyre në mbajtjen e paqes dhe sigurisë në vend.

Ne, gjithashtu besojmë se ky libër-rrëfyes do të inkurajon qeverinë qëndrore and Ministrinë për punë dhe politikë sociale/departamentin për mundësi të barabarta mes grave dhe burave, që të inkuadrohen në ciklin e ri të planifikimit dhe zbatimit të Planit të dytë nacional për zbatimin e Rezolutës 1325 të KS të KB.

## II. Rëndësia e Rezolutës 1325 të KSOKB në shoqërinë bashkëkohore dhe si ka ndryshuar natyra e konfliktit dhe paqes

Para pesëmbëdhjetë vitesh, Rezoluta 1325 e KS të KB e riafirmoi rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë dhe inkuadrimit e plotë të grave në të gjitha përpjekjet për mbajtjen dhe promovimin e paqes dhe stabilitetit. Gjatë viteve më pas, këtë vendim e ka përforcuar me miratimin e gjashtë rezolutave tjera për gratë, paqe dhe siguri.

Rezoluta 1325 ishte një ndër arritjet më të mëdha të lëvizjes globale të grave dhe një ndër vendimet më inspiruese të Këshillit të Sigurimit të OKB. Pranimi se paqja është në mënyrë të pandashme e lidhur me barazinë gjinore dhe udhëheqësinë e grave ishte një hap radikal për organin më të lartë që ka për detyrë mbajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Përkthimi i fjalëve të Këshillit të Sigurimit në vepra dhe ndryshimet reale kanë qenë pasioni shtytës i shumë vepruesve që nga miratimi i rezolutës si normë globale në vitin 2000.

Që nga Lufta e Dytë Botërore, numri aktual i konflikteve dhe numri i civilëve të prekur nga konfliktet ka rënë në mënyrë drastike. Por, përshtypja publike akoma thotë se bota është në situatë konfliktesh dhe krizë pa presendan dhe shkatëruese. Njëra prej arsyeve për këtë është se mediat globale dhe përparimet në teknologjinë e komunikimit kanë sjellur një realitet të ashpër të konflikteve ekzistuese në dhomat e ditës dhe në vendet e punës së njerëzve, duke ia rritur vetëdijen e tyre për shkallën e shkatërrimit, dhe dhimbjen dhe vuajtjen e viktimave civile. Ndërlidhshmëria jonë e bën këtë të duket se konflikti është shkatërues dhe pa fund.

Së dyti, konfliktet në shumë pjesë të botës zgjasin. Në këto situata, për civilët që jetojnë në këto vende, dhuna bëhet normale, kryekomandantët bëhen heroj, ekonomia është e parregulluar dhe këto shtete mbesin të brishtë për periudha të gjatë kohore. Këto konflikte të zgjatura shkatërrojnë jetën e njerëzve. Veprimet kriminele bëhen të shpeshta si trafikim me narkotikë, me njerëz dhe kontrabandimi dhe korrupsioni fillojnë të dominojnë jetën e përditshme.

Së treti, që nga viti 2001, natyra e konflikteve në sfera të caktura dhe specifike ka ndryshuar në mënyrë dramatike. Në fakt, në një anketë që u ndërrom nga organizatat e shoqërisë qytetare për Global Study<sup>1</sup>, 84 përqind e të anketuarve thanë se çështjet brengosëse janë ekstremizmi i dhunshëm dhe kundër-terrorizmi. Gjatë viteve 90ta, shumica e luftërave ndodh-

1 <http://wps.unwomen.org/~media/files/un%20women/wps/highlights/unw-global-study-1325-2015.pdf>

nin në Afrikë, të lidhur me sistemin e brishtë të shteteve dhe komandantët e fuqishëm. Sot, ekzistojnë lloje të reja të konflikteve, që në mënyrë të drejtpërdrejtë inkuadrojnë popullatën civile në mënyrë të pashembulltë.

Përderisa aktet terroriste kanë qenë fenomene të rregullta edhe më parë, që nga viti 2001, natyra dhe shkalla e konflikteve kanë treguar se janë shkatërruese në nivele të papara. Vetëvrasjet me bomba dhe eksplozivë me qëllim të vrasjes së civilëve duket se arrin kulmin gjatë dekadës së parë të këtij shekulli. Vrazhdësia dhe brutaliteti i tyre ka lënë komunitetin ndërkombëtar të tronditur por jashtëzakonisht të bashkuar.

Periodha nga viti 2000 ka parë një sërë inovacionesh teknologjike që e ndryshojnë edhe natyrën e luftimeve. Derisa ka pasur shfrytëzime positive të teknologjisë në mbrojtjen e popullatës dhe në ndihmesat humanitare, teknologjia e armëve të përdorura në konflikte është shumë më shkatërruese. Armët e luftës pa njerëz, llojet e reja të aeroplanëve dhe armëve të reja për luftë në tokë kanë paraqitur dilema të reja dhe të paparashikueshme për gratë që jetojnë në zonat e luftës. Kjo është dekadë ku prerjet e kokëve transmetuar drejtpërdrejt të individëve ekzistojnë bashkë me targetimin klinik të vendeve dhe individëve ku gratë janë vetëm numra në atë që quhet “dëm kolateral”. Kështu, gratë në këtë shekull mund të përdhunohen nga banda dhe gjymtohen në një kontinent, duke kërkuar ndihmë për mbijetim dhe duke u trajtuar si anonim ose si numër klinik në një tjetër.

Luftërat e sotme, pa marrë parasysh nëse janë luftime në mënyrë tradicionale ose luftim asimetrik, kanë rezultuar në numër më të madh të njerëzve të zhvendosur në brendësi dhe refugjatë që nga Lufta e dytë botërore, duke shkaktuar pasoja të tmershme humanitare. Kjo është bërë edhe më e vështirë nga fakti se hapësirat humanitare të shenjta dhe neutraliteti i aktorëve humanitarian nuk respektohet çdoherë, duke e lënë popullatën civile thellësisht të prekshme, me pak gjasa për mbijetim, përveçse si refugjatë ose njeri i zhvendosur. Në këtë kontekst, gratë më të moshuara zakonisht dalin si aktorë humanitar dhe paqeruajtës, sepse ata janë të vetmet njerëz që kanë legjitimitet dhe besim në të gjitha anët për të kryer punë humanitare.

Duke i bërë këto kritika, një njeri nuk mund të behët i verbër ndaj kërcënimeve të caktuara të shkaktuara nga grupe ekstremiste të dhunshme me preardhje të ndryshme etnike dhe religjioze të cilët nuk njohin mospajtim, demokraci ose të drejtat e grave. Mirëpo, mendimi i grave që jetojnë në këto vende por edhe i grave që punojnë në sfera të caktuara ishte se forca vetë nuk mund të jetë përgjigje. Duhet të ketë theks më të madh në parandalim, fuqizimin e grave ndërtuese të paqes, duke respektuar autonominë e tyre, dhe më shumë

resurse të vendosura për ti bërë strategjitë e parandalimit të realizueshme. Konfliktet duhen parandaluar, dhe nëse ato janë të pashmangshme, atëherë duhet të jenë më të njerëzishëm.

Përderisa praktikata e luftës kanë ndryshuar në disa pjesë të botës, ka ndryshuar edhe perceptimi i “shkaqeve rrënjësore”. Në kohën e luftërave menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, luftëra nacionaliste apo luftërat politike ishin të bazuara në ideologji politike, derisa shumë prej luftërave të sotme janë fetare ose etnike në origjinë. Ato janë fuqimisht në fushën e politikës së identitetit dhe në formën e tyre më ekstreme, thellësisht konservatore dhe reacionare ndaj grave dhe të drejtat e tyre.

Në vitin 2000, kur u miratua Rezoluta 1325, çështjet e mëdha me të cilat përballen gratë në situata konflikti ishin:

- Brutaliteti i dhunës seksuale,
- Humbja e fëmijëve apo të dashurve në konflikt,
- Të detyruar ose vullnetarisht të bëhen luftëtar, dhe/ose, refugjatë, ose persona të zhvendosur brenda vendit

Sot, të gjitha këto shqetësime mbeten, por përveç kësaj, në luftëra të caktuara, shqetësimet e grave janë bërë, më të tmershme, përderisa natyra e luftës pushton hapësirat e tyre më private, ato hapësira në familje dhe në komunitet, ku ndjenja e tyre e identitetit dhe siguria janë thellësisht të kërcënuar. Në çdo njërin nga këto situata të reja, ata janë ballafaquar me zgjedhje të pamundshme dhe rigjide dhe si rezultat, shpesh dhe në vazhdimësi janë duke jetuar në një gjendje të pasigurisë dhe ambivalencës.

Në vitin 2000, kur Këshilli i Sigurisë miratoi Rezolutën 1325, pas luftërave në Bosnjë dhe Ruandë, bota ishte një vend i bashkuar sidomos rreth çështjeve të grave, paqes dhe sigurisë, si dhe fëmijëve dhe konflikteve të armatosura. Një pjesë e madhe e aktivitetit rezultoi nga kjo rezolutë në nivel ndërkombëtar, kombëtar dhe rajonal. Megjithatë, që atëherë, edhe pse ka pasur hapa të mëdha përpara në lidhje me dhunën seksuale, atmosfera e konsensusit të lehtë ka ndryshuar në mënyrë të qartë. Procesi politik është shumë më i polarizuar, si brenda Këshillit të Sigurimit dhe jashtë, dhe vendimet merren me ritme të ngadalta për shkak të mosbesimit dhe frikës të agjendave të fshehta. Ky polarizim dhe mosbesim kanë marrë një taksë mbi gratë, paqen dhe rendin e ditës të sigurisë, si dhe tema të tjera në axhendën e Këshillit.

Teksti i plotë i Rezolutës 1325 është dhënë në Shtojcën 1 të këtij dokumenti

Për këtë arsye, ka pasur një besim në mesin e aktorëve që në dekadën e ardhshme për gratë,

paqen dhe sigurinë duhet të fillojnë të identifikojnë forume dhe institucione tjera për të çuar çështjet përpara. Në këtë drejtim, jo vetëm forume tjera shumëpalëshe të lidhura me OKB, por, gjithashtu, organizata rajonale dhe organizata nën rajonale janë identifikuar që mund të ndihmojnë në sigurimin e zbatimit të Rezolutës 1325.

Qeveritë kombëtare janë thirrur për t'u bërë drejtues kryesorë të 1325 dhe organizatat e grave për tu finansuar në mënyrë adekuate në nivelin e komunitetit për të siguruar që ata ta mbajnë qeveritë e tyre të përgjegjshëm.

Ne duhet të pranojmë se që nga viti 2000, natyra e “paqes” dhe çfarë ne kuptojmë kur ne mendojmë “paqë” ka ndryshuar gjithashtu. Për dekada me radhë, paqja nënkuptonte kryesisht heshtjen e armëve dhe rinovimin e politikës formale si mënyrën e qeverisjes. Armëpushimet dhe demobilizimi ishin fokusi kryesor i proceseve të paqes. Megjithatë, sot është e njohur se paqja është diçka shumë më tepër se ‘mungesa e dhunës. Paqja mendohet si një proces gjithëpërfshirës politik, një përkushtim për të drejtat e njeriut në periudhën e pasluftës dhe një përpjekje për t'u marrë me çështjet e drejtësisë dhe pajtim. Paqja e qëndrueshme është e mundur vetëm nëse ka paqë gjithëpërfshirëse, me fjalë të tjera, ajo përfshin të gjitha palët e interesuar dhe në mesin e tyre gra.

Në mënyrë të ngjashme me luftën dhe paqen dhe natyrën e “Sigurimit” dhe të kuptuarit tonë të sigurisë ka ndryshuar. Në periudha të mëparshme, edhe siguria është parë në kontekstin e “mungesës së dhunës.” Sot, siguria shikohet në një mënyrë shumë më ekspansive që nuk është i kufizuar vetëm në përmbajtjen e dhunës fizike.

Siguria gjithashtu ka dimensione politike, ekonomike dhe sociale. Është publike dhe private. Kjo do të thotë mungesë e frikës, por edhe mungesë e dëshirës. Ajo gjithashtu nënkupton agjenci aktive, që do të lejohet të merr pjesë në vendimet që janë bërë në emrin tuaj. Derisa më parë siguria ishte e lidhur me sigurimin e mbijetesës së individëve, në kohët e fundit ajo është e njohur si një term më i gjerë që synon sigurimin e mirëqenies së individëve dhe komuniteteve të tyre.

Përderisa gratë nuk ishin një faktor i madh në përcaktimet e mëparshme të sigurisë, metodat e tanishme, të cilat përfshijnë sigurinë në shtëpi dhe komunitetin, i bëjnë ata aktorë qendror dhe grupe interesi.

### III. Histori e shkurtë e Agjendës për grate, paqe dhe siguri në kontekst ndërkombëtar dhe në Republikën e Maqedonisë

Agjenda e sotme për gratë, paqe dhe siguri është produkt i më shumë se një shekulli i aktivizmit paqësor ndërkombëtar të gruas. Lëvizja qytetare globale e grave të shoqërisë civile për paqe për herë të parë u shfaq si protestë e shkatërrimit që la pas Lufta e Parë Botërore, dhe ka evoluar gjatë disa dekadave prej organizimit të vogël në shkallë të organizimit në nivel lokal dhe kombëtar. Për herë të parë, gratë pacifistë nga e gjithë bota u mbledhën në Kongresin ndërkombëtar të grave në Hagë më 28 prill 1915, të vendosur “për të studiuar, për të njohur dhe për të eliminuar shkaqet e luftës”. Një rezultat i Kongresit ishte themelimi i Ligës ndërkombëtare të grave për paqe dhe liri (LNGPL), që mbetet aktiv si një lider në lëvizjen për gratë, paqen dhe sigurinë sot. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, lëvizja e Ligës ndërkombëtare të gruas ka vazhduar për të avokuar për një fund të konfliktit dhe për çarmatim ndërkombëtar. Paqja si një qëllim në vetvete ka qenë në qendër të agjendës së tyre.

Menjëherë pas themelimit të Kombeve të Bashkuara në vitin 1945, Komisioni mbi statusin e grave (KSG) u krijua në vitin 1946 si organ i OKB-së dedikuar barazisë gjinore dhe përparimit të grave. Komisioni vazhdon të takohet çdo vit, duke sjellë së bashku shtetet anëtare dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile së bashku, për të diskutuar çështje të ngutshme me të cilat ballafaqohen gratë në botë, për të vlerësuar progresin dhe për të bërë rekomandime, dhe formulimin e politikave për barazi gjinore.

Gjatë dekadës së fundit, ka pasur një ndryshim pozitiv në kuptimin e rëndësisë së sjelljes së grave dhe perspektivave të grave lidhur me sigurinë në vendimmarrje. Kjo është reflektuar edhe në miratimin e gjashtë rezolutave pasuese përveç Rezolutës 1325, dhe shtatë rezolutat bashkë përbëjnë Agjendën për gratë, paqe dhe siguri.

Secili prej rezolutave është sqaruar shkurtimisht më poshtë.

- UNSCR 1325 (2000) është rezoluta e parë nga rezolutat tematike për gratë, paqe dhe siguri. Ajo potencon rolin e rëndësishëm të grave në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë dhe të plotë të grave në të gjitha përpjekjet për të mbajtur dhe promovuar paqen dhe sigurinë. Ajo inkurajon shtetet për të ngritur pjesëmarrjen e grave në procesin e vendimmarrjes sa i përket paqes dhe konflikteve dhe në parandalimin e konflikteve dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave, për të përforcuar mbrojtjen e grave dhe vajzave

dhe të drejtat e tyre, dhe për të integruar aspektin gjinor në aktivitetet e shërimit.

- UNSCR 1820 (2008) fokusohet në dhunën seksuale në konflikt të armatosur. Ajo thotë se përdhunimi dhe format e tjera të dhunës seksuale përdoren ndonjëherë si një taktikë lufte, dhe i njeh këto krime si një krim të mundshëm të luftës, krim kundër njerëzimit ose një akt konstituiv të gjenocidit.
- UNSCR 1888 (2009) fokusohet në dhunën seksuale në konfliktet e armatosura dhe e përforcon UNSCR 1820. Kjo rezolutë kërkon nga Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara të emëron Përfaqësues Special për dhunë seksuale në konflikt.
- UNSCR 1889 (2009) në veçanti merret me rolin e grave në situata pas konflikteve. Ajo kërkon nga vepruesit në nivele të ndryshme që të siguron gratë të përfaqësohen më mirë në proceset e zgjidhjes së konflikteve dhe të paqes.
- Rezoluta 1960 (2010) fokusohet mbi dhunën seksuale në konflikt të armatosur, dhe shpreh shqetësimin me mungesën e përparimit në këtë çështje. Ajo argumenton se dhuna seksuale duhet të shihet si një kriter për sanksione kundrejt palëve fajtoresh.
- Rezoluta 2106 (2013) fokusohet në luftimin e dhunës seksuale në kontekstin e konfliktit të armatosur, duke u bërë thirrje të gjitha palëve që të bëjnë më shumë për të luftuar këto krime. Ajo vëren më tej se rreziku i armëve duke në përdorim për të krijuar dhunë të bazuar në gjini është kriter që shtetet eksportuese duhet ta konsiderojnë, në bazë të Traktatit të Tregtisë me armë të reja.
- Rezoluta 2122 (2013) thekson angazhimet e bëra në Rezolutën 1325. Ai fokusohet në qasjen e grave në drejtësi në periudhat kalimtare dhe pas konfliktit, duke përfshirë dëmshpërblime për viktimat. Ajo më tej thekson fuqizimin e grave dhe pjesëmarrjen në të gjitha aspektet e vendimmarrjes në lidhje me konfliktin

Një temë e përsëritur në mes të rezolutave është thirrja për më shumë të dhëna dhe një vlerësim sistematik i ndikimit të konfliktit të armatosur mbi gratë dhe vajzat. Gjithashtu një njohje që duhet të ketë kuptim më të mirë të asaj që do të thotë integrimi gjinor në aspektin praktik, përtej arritjes së një ekuilibri të numrit të grave dhe burrave.

Shtyllat e këtyre rezolutave janë:

- Pjesëmarrja e grave në të gjitha çështjet e lidhura me paqë, siguri dhe konflikt;
- Përfshirja e grave dhe perspektiva gjinore në parandalimin e konfliktit dhe të ba-

zuar në gjini apo dhunë seksuale;

- Mbrojtja e grave dhe vajzave dhe të drejtat e tyre në kohë paqeje dhe gjatë konfliktit;
- Përfshirja e grave dhe perspektiva gjinore në aktivitete lehtësimi dhe shërimi (përfshirë ndjekjen penale të autorëve të krimeve seksuale dhe gjinore dhe aktivitetet për ndërtimin e paqes dhe paqeruajtjes).

Këto katër shtylla janë të ndërlidhura. Pjesëmarrja e grave është një temë kryesor, por ajo është edhe një mjet dhe një fund në vetvete. Në njërin anë, gratë duhet t'ju jepet mundësia për të marrë pjesë në aktivitetet e konfliktit dhe ato paqësore thjeshtë sepse kjo është e drejta e tyre demokratike për ta bërë këtë. Por pjesëmarrja e grave është gjithashtu një mjet për:

- arritjen më të madhe të vetëdijes gjinore në analizën e konflikteve;
- sigurimin e perspektivave të grave që janë marrë parasysh në vendbanimet e paqes;
- rritja e mbrojtjes së grave; duke përfshirë edhe ato në përpjekjet për rindërtim, dhe kështu me radhë.

Këto lidhje tregojnë se katër shtyllat janë të lidhura thelbësisht dhe shpesh janë reciprokisht përforcuese.

## 1. Gratë, paqja dhe siguria dhe agjenda zhvillimore në Maqedoni

Plani nacional i veprimit për barazi gjinore (PNVBGJ) 2007–2012, përgatitur nga Ministria për punë dhe politikë sociale, është dokumenti i parë që në mënyrë specifike inkadron aspektin gjinor në politikën e Maqedonisë për paqe dhe siguri, dhe përmban qëllim strategjik që pjesërisht mbulon zbatimin e Rezolutës 1325.

PNVBGJ e thekson rolin udhëheqës të grave dhe grupeve të grave në Maqedoni gjatë konfliktit dhe në kushte pas konfliktit, nëpërmjet të pjesëmarrjes së tyre në lëvizjen e fuqishme kundër luftës dhe kontributin e tyre për lehtësimin e pasojave për civilët, me theks të veçantë në refugjatë dhe njerëz të zhvendosur, shumica e të cilave kanë qenë gra dhe fëmijë.

PNVBGJ ka definuar nëntë qëllime strategjike dhe njëri prej tyre është të qenit gra në aktivitetet paqeruajtëse. Qëllimi strategjik sa i përket grave në aktivitetet paqeruajtëse ngërthen 5 sfera kryesore:



- Organizimin e fushatave dhe aktiviteteve edukative për promovimin publik të Rezolutës 1325;
- Prodhimin e programeve edukative për promovimin e kulturës së paqes, mos dhunës dhe dialogut multi-etnik;
- Formimin e ekipeve trajnuese për promovimin e Rezolutës 1325, aspektit gjinor, të drejtat e grave dhe komunikimit paqësor;
- Dizejnimin e programeve trajnuese për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave për zyrtarë sigurie dhe përfaqësues të misioneve paqësore; dhe
- Analizën e nevojës për të përshtatur regullativën ligjore shtetërore në përputhje me Rezolutën 1325.

Edhe pse PNV duket se mbulon parimet kryesore të rëndësishme të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të KB: pjesëmarrjen e grave, mbrojtjen nga dhe parandalimin e dhunës së bazuar në gjini dhe konflikte, duhet të theksohet se nuk është e mjaftueshme kur e kemi parasysh përpjekjet e bëra për zbatimin e tyre dhe mjetet financiare të alokuara për zbatimin e aktiviteteve.

Duke i pasur parasysh dokumentet tjera strategjike që kanë të bëjnë me mundësi të barabarta dhe avansimin e pozitës së grave në shoqëri, të reflektuar në këto çështje në masë të ndryshme deri më 2012 kur procesi gjithëpërfshirës konsultues për zhvillimin e Planit nacional për veprim të RM për zbatimin e Rezolutës 1325 u lansua. Prosesi përfundoi në janar të vitit 2013 me miratimin e Planit nga qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Me rëndësi të veçantë në ndjekjen e Agjendës për gratë, paqë dhe siguri në vend ishte inkuadrimi i organizatave të shoqërisë qytetare (OJQ). Edhe pse numri i OJQ-ve që fokusohen në çështjet gjinore dhe në ndikimin e konfliktit të gratë është relativisht i kufizuar, këto organizata ishin në mënyrë aktive të inkuadruar në lëvizjen kundër luftës dhe kishin kontribut substancial në ndërtimin e paqes, pajtimit dhe përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në Maqedoni dhe në rajon gjatë dhe pas periudhës së konfliktit. Ata ndihmuan t'i zbusin efektet e luftës mbi civilët, duke u fokusuar në refugjatë dhe njerëz të zhvendosur në brendësi, shumica e të cilëve ishin gra dhe fëmijë.

Aktivitetet e ndërmarra nga OJQ ishin kryesore në vendosjen e skenës për zhvillimin e PNV 1325. Për më tepër, këto organizata kanë bërë përpjekje të konsiderueshme për të krijuar bazë solide për zhvillimin e PNV 1325, duke ndërmarrë fushata për ngritjen e vetëdijes, punëtori dhe trajnime për të edukuar institucionet relevante dhe publikun në përgjithësi rreth rëndësisë së PNV 1325. Mirëpo, vetëm në shkurt të vitit 2012 u ndërmorrën hapat e

para konkrete në drejtim të zhvillimit të PNV 1325 nga ana e Ministrisë për punë dhe politikë sociale, kur u themelua grupi punues përgjegjës për koncipimin e planit të veprimit.

## 2. Reforma në sektorin e sigurisë në vend

Një aspekt tjetër njësoj i rëndësishëm i agjendës për grate, paqë dhe siguri në Republikën e Maqedonisë është tranzicioni dhe reformat në sektorin e sigurisë. Më poshtë është siguruar një përmbledhje e shkurtër<sup>2</sup> e reformës që jep indikacion se stabiliteti ndëretnik është i lidhur dhe ndikon në masë të madhe në sistemin e sigurisë së vendit

Maqedonia deklaroi pavarësinë e saj në vitin 1991, si pasojë e shpërndarjes së Jugosllavisë. Dekada e parë e pavarësisë (1991-2001) shënoi vendosjen e institucioneve themelore shtetërore dhe praktikave demokratike. Armata e Republikës së Maqedonisë, u formua gjatë kësaj periudhe, si një nga shtyllat esenciale të sektorit të sigurisë. Hapa preliminare janë ndërmarrë për të reformuar sektorin tjetër të sigurimit dhe kthimin e tyre në aktorë të sigurisë demokratike, edhe pse transformimi i plotë mbeti i kufizuar në hapsirën e vet.

Kjo periudhë dëshmoi edhe përkeqësimin e marrëdhënieve ndëretnike, duke e shtyer vendin në konflikt të armatosur në vitin 2001, i cili edhe pse ishte i shkurtër, zbuloi mangësitë e sektorit të sigurisë së Maqedonisë.

Marrëveshja Kornizë e Ohrit e përfundoi konfliktin e armatosur dhe siguroi reforma substanciale për sistemin politik, sektorin publik dhe sektorin e sigurisë. Në thelb, Marrëveshja e Ohrit siguron përfaqësim adekuat dhe proporcional të komuniteteve të ndryshme të Maqedonisë. Rezultati i drejtpërdrejtë i Marrëveshjes së Ohrit për policinë ishte vendosja e patrolimit multi-etnik në vendet me banorë etnikisht të përzier.

Në drejtim të integritetit gjinor, ligji zgjedhor u ndryshua në vitin 2002 për tu harmonizuar me Marrëveshjen e Ohrit. Grupet lobuese të grave në sektorë formal dhe joformal e shfrytëzuan këtë moment për të avokuar për ndryshime, duke rezultuar në miratimin e kuotave zgjedhore që kërkojnë të paktën 30 përqind të përfaqësimit të çdo gjinie në listat zgjedhore (Ligji për Zgjedhjen e deputetëve të Kuvendit, 2002).

Vitet pas nënshkrimit të marrëveshjes së Ohrit (2001-2008) janë karakterizuar si periudhë

<sup>2</sup> Pasqyra është miratuar për qëllimet e këtij dokumenti nga publikimi "Gratë, paqja dhe siguria në Ballkanin perëndimor", Qendra e Beogradit për politika të sigurisë, 2013 f.90.

pas konfliktit dhe integruese. Përpjekje janë bërë për t'u mëkëmbur nga konflikti dhe për tu kthyer politikës paqësore, derisa në anën tjetër në mënyrë simultane janë ndërmarrë masa që kishin për qëllim integrimin e Maqedonisë në organizata ndërkombëtare si në BE dhe NATO. Ky kombinim i veprimeve rezultoi në aktivitetet të rritur të reformave në sektorët publik dhe atë të sigurisë.

**Tekst në kuti 1:** (Mos) Inkuadrimi i grave në negociatat e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit

*Dialogu politik që parapriu nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit ndodhi gjatë verës së 2001 me nënshkrimin e marrëveshjes me 13 gusht të vitit 2001.*

*Nëse i analizojmë pjesëmarrësit e inkuadruar në negociatat, ndërmjetësim dhe mbështetësit nga komuniteti ndërkombëtar, ne nuk arrijmë të identifikojmë asnjë anëtar femër në tre ekipet e analizuar.*

*Edhe pse gratë kanë mundur të marrin pjesë në pozitë të këshilltarëve dhe/ose mbështetjes të ekipeve në kuptim të dukshmërisë dhe imazhit publik gjatë procesit të negociatave dhe nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, ato ishin të padukshëm. Më poshtë ne sigurojmë përbërjen e plotë të ekipeve të involvuar.*

*Diskutimet politike në negociatat në Shkup u mbajtën nën sponsorizimin e kryetarit Boris Trajkovski.*

*Negociatorët: Përfaqësues të partive kryesore maqedone dhe shqiptare që morrën pjesë: VMRO-DPMNE, i udhëhequr nga Ljubco Georgievski; Partia Demokratike e shqiptarëve, PDSH, i udhëhequr nga Arben Xhaferi; LSDM, i udhëhequr nga Branko Crvenkovski dhe partia për prosperitet demokratik, PPD, Imer Imeri.*

*Lehtësuesit e dialogut: James Pardew nga Departamenti i shtetit dhe Francois Leotard, politikan i penzionuar francez.*

*Përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar: Përfaqësuesi i lartë i BE për politikë të jashtme and siguri, Javier Solana, dhe Sekretari i përgjithshëm i NATO, Lord George Robertson dhe përfaqësuesi i OSBE Mircea Geoana*

Periudha pas vitit 2008 dëshmoi ngadalsimin e tempos së reformave në sektorin e sigurisë si rezultat i vetos kundër anëtarësimit në NATO dhe i mungesës së progresit të mirëfilltë në përpjekjet për anëtarësim në BE. Mirëpo, kjo periudhë shënoi edhe intensifikimin e aktiviteteve në drejtim të integritetit të aspektit gjinor në sektorin e sigurisë.

#### IV. Prezantimi i Planit nacional për veprim të Republikës së Maqedonisë për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurisë të OKB

Plani nacional për veprim u miratua nga qeveria e Republikës së Maqedonisë me 9 janar të vitit 2013 pas procesit pjesëmarrës të tërësishëm për zhvillimin e tij të udhëhequr nga Ministria për punë dhe politikë sociale të mbështetur nga Ministria për mbrojtje<sup>3</sup>. Procesi i zhvillimit të Planit nacional për veprim zgjati një vit.

Pas organizimit të hulumtimit<sup>4</sup> me qëllim të identifikimit të pikave hyrëse për zbatimin e Rezolutës 1325, në shkurt të vitit 2012, u themelua një grup punues për përgatitjen e PNV 1325 nga përfaqësuesit e institucioneve shtetërore (Ministria për punë dhe politikë sociale, Ministria për punë të jashtme, Ministria për punë të brendshme, Ministria për mbrojtje dhe Qendra për menaxhimin me kriza), tre asociacione të grave (Antiko, NCWM–UWOM dhe Lobi i grave të Maqedonisë, përfaqësues nga UN Women dhe institucionet akademike.

Procesi i zhvillimit të PNV 1325 ishte transparent dhe inkluziv sepse i inkuadroi të gjithë palët e rëndësishëm në proces. Grupi punues ishte përgjegjës për përgatitjen e aktiviteteve për tu zbatuar nga ministritë relevante në PNV. Verzioni punues i PNV u prezantua dhe diskutua në tetë punëtori lokale. Qëllimi i punëtorive lokale ishte që të mbledh informata në nivel lokal që më vonë të shqyrtohet në seancën e gjashtë të grupit punues gjatë procesit të definimit të PNV.

Përderisa pushteti lokal ishte angazhuar me punëtori, Kuvendi u angazhua që nëpërmjet të Komisionit parlamentar për mundësi të barabarta mes grave dhe burrave të organizon debatë publike rreth verzionit punues të PNV 1325. Ministria për punë dhe politikë sociale publikoi verzionin punues të PNV 1325 në faqen e tyre të internetit, duke e bërë kështu dokumentin publikisht të qasshëm. Ky proces konsultimi dhe pjesëmarrës, që mori parasysh mendimet e ndryshme, nevojat dhe interesat e palëve të inkuadruara, e bëri të mundur që mendimet e ndryshme të merren parasysh dhe krijoi aleanca në mes të palëve të ndryshme.

<sup>3</sup> Ministria për punë dhe politikë sociale kishte memorandum për bashkëpunim me Ministrinë për mbrojtje në zhvillimin e Planit nacional për veprim.

<sup>4</sup> Mapim studim për zbatimin e UNSCR 1325 dhe pikat hyrëse për zhvillimin e PNV për UNSCR 1325

Ky proces e rriti edhe pronësinë dhe përgjegjësinë duke ngritur nivelin e mbështetjes për zbatimin e PNV.

Ashtu si u tha edhe më lartë, PNV u miratua në janar të vitit 2013<sup>5</sup> bashkë me planin operativ për zbatimin e tij për 2013 . Ky plan definon drejtimet politike, parimet, palët e involvuar/ tanguar, aktivitetet, strategjitë, treguesit, monitoringun dhe vlerësimin, si dhe implikimet financiare për zbatimin e aktiviteteve.

Ekzistojnë tre qëllime strategjike të PNV për zbatimin e Rezolutës për grate, paqë dhe siguri që kanë për qëllim të:

- përforcojnë aspektin e gjinisë në paqen, sigurinë dhe politikat e mbrojtjes së vendit, me theks të veçantë në parandalimin e konflikteve, sistemet për paralajmërim të hershëm, reduktimin e rrezikut, menaxhimin me katastrofa dhe zhvillimin e politikave;
- rrisin pjesëmarrjen dhe përforcimin e rolit të grave në paqëruajtje (civile dhe ushtarake) atje ku Republika e Maqedonisë merr pjesë,
- parandalojnë dhunën ndaj grave në situata para dhe pas konflikti, si dhe gjatë krizave humanitare të shkaktuara nga katastrofat natyrore

Gjatë definimit të këtyre qëllimeve strategjike, janë marrë në konsideratë 18 provizione të Rezolutës 1325. Këto provizione janë të ndarë në tre kategori:

- Përfaqësimi: përfaqësim i rritur dhe pjesëmarrje e grave në nivelet e vendim marrjes në institucionet shtetërore, rajonale dhe ndërkombëtare, menaxhimi i konflikteve, parandalimi, zgjidhja dhe ndërtimi i paqes.
- Aspekti gjinor: aspekti gjinor duhet të inkuadrohet gjatë planifikimit dhe zbatimit të operacioneve paqësore dhe negociatave;
- Mbrojtja: kujdes të rritur për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të grave (duke inkuadruar mbrojtje kundër dhunës të bazuar në gjini).

Nga analiza e mëtutjeshme e PNV nëpërmjet të parimeve kryesore të Rezolutës 1325, ne mund të përfundojmë këtë si vijon:

5 Të gjitha dokumentet janë në dispozicion në internet faqen e Ministrisë për punë dhe politikë sociale [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk) nuk ka dëshmi të planit operativ për zbatimin e PNV për 2015 dhe 2016. Nuk ekzistojnë raportet vjetorë të zbatimit dhe risitë dhe cka është arritur nga PNV në baza vjetore.

**Pjesëmarrja** më shpesh përkthehet në dy qëllime: së pari, pjesëmarrje e rritur nga ana e grave në vendim marrje në përgjithësi dhe së dyti përfaqësim të rritur të grave në pozitave operative dhe të vendim marrje në sektorin e sigurisë së vendit dhe në operacionet paqëruajtëse. PNV ka për qëllim rritjen e pranisë së grave në institucionet e sektorit të sigurisë që kanë të bëjnë me policinë, mbrojtjen, menaxhimin e krizave mbrojtjen civile dhe menaxhimin e kufijëve të integruar.

Rezoluta gjithashtu pranon në mënyrë më eksplicite rolin e gruas në menaxhimin e konflikteve, parandalimin, zgjidhjen dhe ndërtimin e paqes në shtëpi dhe jo vetëm në misionet ndërkombëtare paqëruajtëse. Më konkretisht, NPV njehevojën për të respektuar nevojat e grave të prekura nga masat për ndërtimin e paqes dhe parandalimin e konfliktit që dalin nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit (MKO). Ajo ka për qëllim për të rritur pjesëmarrjen e grave në politikë dhe në aktivitetet e Sekretariatit për implementimin e MKO, si dhe në zbatimin e Strategjisë për përfaqësim të barabartë të komuniteteve që nuk përfaqësojnë shumicën dhe Planit të veprimtimit shoqëruar. Në pak fjalë, ajo synon të përfshijë gratë në ndërtimin e paqes në vend dhe gjithashtu të ndihmojë gratë e pakicave etnike të përfaqësohen në të gjitha nivelet e qeverisjes.

PNV njehevojën për të përmirësuar pjesëmarrjen e grave në ruajtjen e paqes dhe të misioneve humanitare. PNV thekson se kjo mund të marrë formën e pjesëmarrjes në të dy misionet ushtarake dhe civile. Duke e njohur se ekziston një bazë e madhe e grave kandidatet potenciale për punë civile, si dhe nevojën për të ndihmuar popullatën lokale, duke siguruar shërbime të tjera nga mbrojtja ushtarake, PNV synon të zhvillojë një kapacitet civil kombëtar për operacionet shumëkombëshe duke vendosur një objektivi për të krijuar një regjistër të centralizuar të kapaciteteve për misionet civile.

**Tabela 1:** Pjesëmarrja e grave në strukturat e vendim marrjes

Zgjedhjet lokale 2013	4 gra kryetare (4.7%) nga gjithsej 81; 405 gra këshilltare (30%) nga gjithsej 1390 këshilltarë
Zgjedhjet parlamentare 2011	42 gra deputete (34.1) nga gjithsej 123 ulëse.
Qeveria e Maqedonisë <sup>6</sup>	Nga 4 zëvendës kryeministër 0 gra (0%), 5 ministra pa portfolio - 0 gra, 2 gra ministrë (14%), 2 zëvendës ministër (14%) dhe 6 sekretarë shtetëror gra (40%) nga 15 ministri.
Administrata publike	Niveli lokal i qeverisë <sup>7</sup> : 3014 gra të punësuar nga gjithsej 5619 burra
Autoritetet juridike <sup>8</sup>	Основни судови: 59,5% од жените судии Апелациски суд: 50,5% од жените судии Врховен суд: 71% од жените судии Управен суд: 67% жени судии

**Mbrojtja.** Parimi i mbrojtjes është i përfaqësuar në qëllimet në drejtim të fuqizimit të grave dhe vazave dhe mbrojtjes së tyre nga dhuna e bazuar në gjini (DHBGJ) dhe kanosjet që dalin nga konfliktet. PNV përmban masa që kanë për qëllim përmirësimin e mbrojtjes së grave në shtetet e veta ose në shtete ku forcat e sigurisë shtetërore mund të vendosen si pjesë e operacioneve paqeruajtëse. PNV ka qëllim fisnik të mbështetjes së grave por ai shumë rrallë e pranon rolin aktiv që gratë mund ta luajnë në parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës të bazuar në gjini, si dhe në paqë dhe siguri.

Plani i kushton vëmendje të veçantë zhvillimit të njohurive dhe kapacitetit për të kuptuar kërcënimet nga dhuna e bazuar në gjini për gratë në mjedisin paqeruajtës, dhe ka dizajnuar masa të tilla si trajnim të specializuar dhe sensibilizim rreth forcës.

**Parandalimi-** Shtylla e parandalimit të Rezolutës 1325 duhet të sigurojë: zbatimin e barazisë gjinore në të gjitha aktivitetet e parandalimit të konfliktit; mekanizmat sensitive gjinore dhe

6 Informata referon qeverinë si rezultat i zgjedhjeve parlamentare 2011-2014.

7 Analizë për pjesëmarrjen kualitative të grave në jetën publike dhe politike në njësitë e vetëqeverisjes lokale [http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/informacija%20za%20analiza\\_lokalna%20samouprava.pdf](http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/informacija%20za%20analiza_lokalna%20samouprava.pdf)

8 Burimi: zyra statistikore per vitin 2010.

institucionet për paralajmërim të hershëm; forcimin e përpjekjeve për të parandaluar dhunën kundër grave; dhe lufta kundër mosndëshkimit për dhunën gjinore dhe seksuale.

Në PNV, parimi “parandalimin” përkthehet në masat që synojnë zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve të sektorit të sigurisë për të parandaluar rrezikun e dhunës dhe kërcënimeve të tjera për gratë. Shumica e këtyre masave kanë për qëllim zhvillimin e masave parandaluese që do të mbrojnë gratë, duke dështuar për të përfshirë gratë si pjesëmarrës aktiv në parandalim. PNV promovon rolin aktiv të grave në parandalimin e konflikteve dhe rimëkëmbjen e shoqërisë pas emergjencave dhe në këtë mënyrë ai pranon një vlerësim në bazë gjinore të rrezikut për fatkeqësitë natyrore, dhe sidomos vulnerabilitetin e grave rurale në krizat natyrore dhe humanitare dhe katastrofat. Ai parashikon angazhimin e grave në konflikt-parandalimin dhe shërimin në nivel lokal përmes Këshillave për parandalim dhe këshillave të komunave, si dhe në bashkëpunim me shoqërinë civile.

Kur është fjala për monitorim dhe vlerësim tre treguesit e përgjithshëm për secilin nga tri qëllime strategjike janë identifikuar:

- Analiza e përmbajtjes së dokumenteve të rëndësishme politike për përfaqësim, llojin dhe shpeshësinë e termave që lidhen me cilësinë gjinore;
- Numri i aplikimeve dhe emërimeve të grave për pjesëmarrje në misionet paqeruajtëse civile dhe ndër-kombëtare është rritur 10% deri në vitin 2015;
- Forcimi i parandalimit të dhunës ndaj grave dhe vazave, si dhe mekanizma të përmirësuar për vlerësimin e rrezikut të ndjeshën gjinor të fatkeqësive natyrore.

Përderisa PNV identifikon Grupin e punës për monitorim të zbatimit, si koordinues kryesor dhe organ mbikëqyrës, ai nuk përfshin informacione specifike se si dhe sa shpesh pjesëmarrësit do të komunikojnë me njëri-tjetrin.

Aktivitetet e planifikuara në PNV nuk kanë implikime financiare, dhe do të përfshihen në institucionet, aktivitetet ekzistuese dhe buxhetet, siç përcaktohet me Ligjin për mundësi të barabarta të grave dhe burrave (2012).

Plani nacional i veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 dhe plani operativ për zbatimin e PKV për vitin 2013 janë dhënë në Shtojcën 2 dhe 3 të këtij dokumenti.

## 1. Sfidat në zbatimin e PNV

Organi përgjegjës për drejtimin e rendit të ditës 1325 është Ministria e punës dhe politikës sociale / departamenti për mundësi të barabarta mes grave dhe burrave. Zgjedhja e organeve të barazisë gjinore në vend të sigurisë ose të institucioneve të politikës së jashtme, si nikoqir për koordinim mund të tregojnë priorizimin e perspektivës së grave në interpretimin lokal të agjendës për gra, paqë dhe siguri.

Përveç MPPS, në zbatimin e PNV janë përfshirë edhe Ministria e punëve të jashtme, Ministria e punëve të brendshme, Ministria e mbrojtjes dhe Qendra për menaxhimin e krizave si institucione kryesore përgjegjëse për zbatimin e PNV.

Zbatimi i PNV-së do të koordinohet nga grupi punues ndërministror i përbërë nga përfaqësues të ministrive përkatëse në bashkëpunim me MPPS. MPPS do të informojë qeverinë rreth aktiviteteve të kryera me anë të raporteve ad hoc për çështje të veçanta, ndërsa qeveria do të informojë parlamentin dhe komitetet e tij për progresin në zbatimin e PNV.

Aktivitetet e planifikuara në PKV do të përfshihen në institucionet, aktivitetet ekzistuese dhe buxhetet, siç përcaktohet me Ligjin për mundësi të barabarta të grave dhe burrave (2012). Edhe pse të gjitha ministrinë kanë emëruar koordinatorët për mundësi të barabarta, institucionet shtetërore posedojnë kapacitete relativisht të kufizuara për zbatimin e PKV 1325 në aspektin e njohurive, njerëzve dhe burimeve, si dhe mungon një kuptim i duhur i konceptit të gjinisë në përgjithësi dhe inkuadrimit të aspektit gjinor, në sektorin e sigurisë në veçanti.

Përderisa nuk ka asnjë raport vjetor në dispozicion për statusin e implementimit të PKV dhe planin përkatës operativ për vitin 2013, ne mund të punojmë vetëm rreth sfidave të parapara, me të cilat palët e përfshira u përballën në bazë të dokumenteve ekzistuese në dispozicion.

Sfidat kryesore për zbatimin lidhen me buxhetimin dhe mekanizmat e dobëta të monitorimit, duke pasur parasysh se NPV nuk ka implikime financiare dhe aktivitetet do të integrohet në kuadër të aktiviteteve ekzistuese dhe buxhetet e institucioneve përkatëse.

Përveç Grupit punues ndërministror për monitorimin e zbatimit, PNV 1325 nuk përcakton një mekanizëm të qartë raportimi i cili do të kërkojë llogaridhënie dhe përgjegjësi nga palët e interesit. Mekanizmi ekzistues i raportimit parashikon që MPPS të informojë qeverinë në lidhje me aktivitetet e kryera me anë të raporteve ad hoc për çështje të veçanta, ndërsa qeveria do të informojë Kuvendin dhe komitetet e tij në lidhje me ecurinë e zbatimit të PNV.

Ekziston nevoja për integrimin gjinor në sektorin e sigurisë për të shkuar përtej përfaqësimit nga politikat dhe legjislacioni, si dhe për të zgjeruar fokusin në përfaqësimin e grave në sektorin e sigurisë në një integrim më të gjerë të konceptit gjinor, i cili adreson nevojat dhe aspiratat e diferencuara mes femrave dhe meshkujve në aspektin e parandalimit të konflikteve, zgjidhjen, menaxhimin dhe ndërtimin e paqes. Përfaqësimi në rritje numerike nuk siguron qasje të përmirësuar në pozita vendimmarrëse. Një rast i tillë është Ministria e Mbrojtjes, me 36.9% të femrave prej të cilëve shumë pak zënë pozita vendimmarrëse. Nga ana tjetër, Ministria e punëve të brendshme është ministria me më pak gra në mesin e fuqisë punëtore të saj, dhe ka qenë i emërtuar si ministri “më mashkullorë”.

Shumë gjëra duhet të kryhen për të reduktuar hendekun në mes të politikës dhe praktikës. Në mënyrë që SSR të jetë efektive, e drejtë dhe demokratike, është e rëndësishme që perspektiva gjinore të integrohet në të gjitha nismat e RSS. Dështimi për të integruar çështjet gjinore në sektorin e sigurisë do të çojë në neglizhenca të mëtejshëm të nevojave të sigurisë së grave dhe vajzave, si dhe burrave dhe djemve të marginalizuar. RSS është e rëndësishme për promovimin e zhvillimit, qeverisjes së mirë dhe paqes, dhe vetë procesi hap një “dritare mundësie” për zbatimin e iniciativave gjinore në nivelet strukturore të politikave dhe të personelit në mënyrë për të rritur pronësinë vendore, ofrimin efektiv të shërbimeve dhe mbikëqyrjen dhe llogaridhënien e sektorit të sigurisë.

### Tekst në kuti 2: Definimi i integritit gjinor

*Definicioni më i përdorur zakonisht për integrimin gjinor është marrë nga raporti i Këshillit Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara (ECOSOC) për vitin 1997 dhe është si vijon: “Integrimi i perspektivës gjinore është proces i vlerësimit të implikimeve për femrat dhe meshkujt e ndonjë veprimi të planifikuar, duke përfshirë legjislacionin, politikat dhe programet, në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet. Kjo është një strategji për të bërë shqetësimet e grave, si dhe të burrave dhe përvojat si një dimension integral të hartimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe programeve në të gjitha sferat politike, ekonomike dhe shoqërore në mënyrë që gratë dhe burrat të përfitojnë në mënyrë të barabartë dhe pabarazia nuk është përjetësuar. Qëllimi përfundimtar është arritja e barazisë gjinore”.*

## 2. Vendosja legjislative dhe institucionale dhe palët e përfshirë

### LEGJISLACIONI

Parimi i barazisë gjinore është inkuadruar në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, që nga miratimi i saj në vitin 1991 (nenet 9, 54 dhe 110). Dimensioi gjinor ishte përfshirë në

dokumentet strategjike të Maqedonisë pas miratimit të CEDAW (e cila hyri në fuqi në vitin 1991). Ka shumë ligje të cilat kanë ngërthyer dispozitat gjinore dhe disa nga ato më të rëndësishme janë Ligji i parë për mundësi të barabarta mes burrave dhe grave (2006), i cili synon për të rregulluar masat themelore dhe të veçanta për vendosjen e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, si dhe përgjegjësitë, detyrat dhe detyrat e subjekteve përgjegjëse për krijimin e mundësive të barabarta, procedurën për përcaktimin e trajtimit jo të barabartë të femrave dhe meshkujve, si dhe të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit për mundësi të barabarta mes grave dhe burrave.

Aktivitetet	<p>Të gjitha brenda 1,2</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendosija e procedurave për inkuadrimit të domosdoshëm të perspektivave gjinore në miratimin e MSDP dhe në zbatimin strategjik të dokumenteve në harmoni me Ligjin për mundësi të barabarta mes grave dhe burrave</li> <li>- vendosja e politikave preventive gjinore brenda MSDP dhe mekanizëm zbatues në nivelin qendror dhe lokal;</li> <li>- Përforcimin e kapaciteteve të koordinatoreve për mundësi të barabarta dhe konsultime me shoqërinë civile/OJQ për çështje të lidhura me politikën paqësore dhe të sigurisë nga perspektiva gjinore – Numri i rasteve të zgjedhura (ose të veprimeve të ndërmarra</li> <li>- % të grave të cilat kanë referuar obligime ligjore që janë aktive në ministritë dhe institucionet relevante në nivelin qendror dhe lokal</li> </ul>	<p>Të gjitha brenda 2,1</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Trajnimi i trajnerëve – TET për persona nga institucionet relevante;</li> <li>- Krijimi i bazës së të dhënave të ekspertëve për Rezolutën 1325 – Zhvillimin e planit trajnues për Rezolutën 1325, Agjendën për gratë, paqë dhe siguri, dhuna e bazuar në gjini (nga njerëzit që do të trajnohen brenda programit TET)</li> <li>- Azhurimi i kurseve të trajnimit për profesional (expert civil dhe ushtarak) që janë të referuar në misionet paqëruajtëse me informata për çështjet gjinore, Rez, 1324, dhuna e bazuar në gjini;</li> <li>- Shkëmbim të përvojës dhe praktikave më të mira në mes të trajnuesve (baza e të dhënave të ekspertëve për Rezolutën 1325 (çështjet gjinore) nga vendet në rajon dhe më gjërë</li> </ul>	<p>3.1:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendosija e grupit punues në mes të departamenteve për vetë vlerësim të perspektivës gjinore të akteve legjislative sa l përket dhunës kundrejt grave dhe vajzave</li> <li>- Prezantimi i masave gjinore për zgjidhjen e konflikteve</li> </ul> <p>Përpilimin e analizës gjinore të situatës sa l përket ndikimit të krizave natyrore dhe humanitare në nivelin lokal dhe nacional (vlerësim të rreziqeve senzitive gjinore);</p> <p>3.2</p> <p>Përmirësim të funksionit të qendrave për shërbime publike për gra – viktimat të dhunës familjare duke i përmirësuar kualitetin e shërbimeve dhe qasjen e tyre deri te këto shërbime, si dhe me vendosjen e proceseve dhe procedurave efikase;</p>

Tabela e mësipërme tregon qartë nevojën për përfshirjen më thelbësore të njësisë të vetëqeverisjes lokale se ishte në PNV-ekzistuese.

Në fakt, rëndësia e qeverisjes vendore është pranuar nga PNV-së ekzistuese, dhe pushteti lokal është reflektuar nën institucionet përgjegjëse për aktivitetet në kuadër të qëllimit strategjik 1 dhe 2. Ne besojmë se pushteti lokal poashtu mund të jep kontribut në qëllimin strategjik.

Me procesin e decentralizimit dhe në kontekstin e fuqizimit të mëtejshëm të administratës komunale, perspektiva e NJVL duhet të përfshihet në të gjitha dokumentet përkatëse, si në procesin e zhvillimit të tyre, por edhe në procesin e zbatimit dhe vlerësimit të rezultateve.

Gjithashtu, duke marrë parasysh parimet e pjesëmarrjes në procesin e përpilimit të politikave, qeveria qendrore duhet të sigurojë që NJVL janë të përfshirë në procesin e hartimit të politikave, pavarësisht nga fakti se implementimi i këtyre politikave nuk është drejtpërdrejt në fushën e qeverisjes lokale.

Për këtë arsye ne shohim një mundësi për përfshirjen e NJVL në të gjitha tre qëllimet strategjike nëpërmjet të zbatimit të drejtpërdrejtë dhe kontribut, apo indirekt duke ofruar perspektivën e saj se si ndikojnë këto politika në qeverisjen lokale.

#### Mekanizmat:

Ka disa mekanizma që mund të përdoren si një pikë hyrje për zbatimin më intensiv të aktivitetëve (për t'u), përcaktuar në PKV e radhës për zbatimin e Rezolutës 1325 të KS të OKB-së. Ato janë:

- Komisionet për marrëdhënie ndërmjet bashkësive (KMNB)
- Komisionet për mundësi të barabarta midis grave dhe burrave të Këshillit Bashkiak dhe Koordinatorit për mundësi të barabarta midis grave dhe burrave në njësitë e vetëqeverisjes lokale
- Këshillat lokale të sigurisë
- Organizatat e shoqërisë civile

Siç është elaboruar më parë, aktivitetet që dalin nga PKV mund të përdoren për zgjerimin e mëtejshëm të stabilitetit dhe sigurisë së vendit. Ndërsa, nga ana tjetër, marrëdhëniet stabile ndëretnike janë një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në stabilitetin dhe sigurinë.

#### Komisionet për marrëdhënie ndërmjet bashkësive (KMNB).

Ne kemi përpunuar në detaje në kapitullin më parë përgjegjësitë dhe përbërjen e KMNB. Këtu ne vetëm theksojmë faktin se qeveritë lokale mund të luajë një rol kyç në identifikimin dhe avancimin e mënyrave efektive dhe efikase për zgjidhjen dhe parandalimin e marrëdhënieve negative ndëretnike. Qeveritë lokale në momente të caktuara janë organet më të ditur për çështjet e nivelit lokal dhe janë në gjendje të marrin në konsideratë dhe të aplikojnë balancën e interesave, duke avancuar kornizën institucionale.

Neni 55 i Ligjit për vetëqeverisje lokale krijon një dispozitë për krijimin e Komisioneve për marrëdhënie mes bashkësive (KMNB) në komunat ku së paku 20% e popullsisë i përket një bashkësie të caktuar etnike. Ligji nuk përjashton komunat tjera për themelimin e KMNBve, të cilët janë organe konsultative të përbërë nga një numër i barabartë i përfaqësuesve të secilës bashkësie të përfaqësuar në komunë.

Sipas ligjit, KMNB shqyrtojnë çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërmjet bashkësive të përfaqësuar në komunë, japin mendime dhe propozime për zgjidhjen e problemeve

që lindin në mes të komuniteteve. Sipas të njëjtit nen, Këshilli Komunal është i obliguar që të shqyrtojë mendimet dhe propozimet e KMNB-ve dhe të marrin vendime.

#### **Komisioni për mundësi të barabartë mes të grave dhe burrave dhe Koordinatori.**

Secila njësi e vetëqeverisjes lokale është e detyruar të krijojë një komision për mundësi të barabarta midis grave dhe burrave si një komision i detyrueshëm të njërive të vetëqeverisjes lokale. Komisioni ka për qëllim përfshirjen e perspektivës gjinore dhe mundësive të barabarta në politikën lokale, për të nxitur pozitën e gruas në nivel lokal dhe për të zbatuar objektivat strategjike të Planit kombëtar të veprimit për barazinë gjinore dhe Ligjin për barazi gjinore midis grave dhe burrave. Përgjegjësia kryesore e komisioneve është që të punojë në promovimin e pozitës së gruas dhe të ofrojë mundësi të barabarta për gratë dhe burrat në nivel lokal, nëpërmjet procesit të hartimit dhe miratimit të politikave, zbatimit, monitorimit të tyre dhe vlerësimit të rezultateve të arritura. Komisioni për mundësi të barabarta kërkohet të paraqes një raport të performancës deri te Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, të paktën një herë në vit. Komisioni përgatit planin e tij të veprimit për mundësi të barabarta duke reflektuar aktivitetet, kohën dhe aktivitetet monitoruese për të arritur objektivat e shpjguara më lart.

Më konkretisht, puna e Komisionit duhet të përqëndrohet në këto aspekte:

- a. Komisioni duhet të përqëndrojë përpjekjet e tij për të siguruar që të gjitha dokumentet e zhvillimit dhe të tilla si strategjitë, programet dhe projektet duhet të rishikohen përmes thjerrëzave gjinore. Për këtë arsye, Komisioni duhet të **INSISTOJË** për të marrë këto dokumente dhe të sigurojë inputet para se ata të miratohen nga këshilli komunal.
- b. Komisioni duhet të jetë në mënyrë proaktive i përfshirë në procesin e përgatitjes së buxhetit. Duke bërë këtë, Komisioni ka qëllim të dyfishtë. I pari është që të sigurohet që buxheti pasqyron aktivitetet e planifikuara në Planin e Veprimit të mundësive të barabarta, të përgatitura nga Komisioni dhe të miratuara nga Këshilli i Komunës. Qëllimi i dytë, që është më i ndërlikuar, është të sigurojë që buxheti i përgatitur e ka të integruar aspektin gjinor. Me fjalë të tjera për të siguruar që aktivitetet finansohen nga fondet buxhetore nga të cilat do të përfitojnë të dy gratë dhe burrat.
- c. Derisa buxheti ndjek programet dhe projektet, qëllimi kryesor i Komisionit duhet të jetë që të sugjerojë dhe të ndikojnë në përmbajtjen e programit të këshillit komunal për punë në aspektin e mundësive të barabarta dhe në këtë mënyrë

aspektet kryesore gjinore në këto dokumente. Si në pikën e parë, Komisioni duhet të shqyrtojë dokumentin përmes lenteve gjinore dhe si të tillë, të sigurojë inputet para se ajo të miratohet dhe finansohet.


- d. E fundit por jo më pak e rëndësishme, Komisioni ka autonomi për të ndikuar në punën e **NJVL**, në **administratën** e tyre dhe **operacionet** e ndërmarra nga perspektiva gjinore. Për shembull, në qoftë se ka përfaqësim jo të barabartë gjinor në bordet menaxhuese, grupeve të punës dhe / ose ndërmarrjeve të NJVL, Komisioni duhet të reagojnë dhe të propozojë ndryshime. Ose, në rast se një shërbim i ofruar për qytetarët nga ana e NJVL nuk është e ndjeshme ndaj nevojave të të dy gjinive, Komisioni duhet të iniciojë ridizejnimin e këtij shërbimi në mënyrë që të përshtaten me nevojat e të dy gratë dhe burrat.

Koordinator për mundësi të barabarta midis grave dhe burrave në njësitë e vetëqeverisjes lokale janë individë nga administrata komunale me statusin e nëpunësit civil të cilët, në mesin e detyrave të tjera, merren, përforcojnë dhe promovojnë barazi dhe masat e barazisë dhe mundësive të barabarta ndërmjet grave dhe burrave. Ai/ajo, në mënyrë plotësuese e mbështet Komisionin në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tij.

Të dy pozitat KMNB dhe KBJG janë relativisht të reja në strukturën e njërive të vetëqeverisjes lokale dhe procesi i tyre evolues është paraqitur grafikisht në tabelën e mëposhtme:

**Grafiku 1:** Evolucion i agjendës ndëretnike dhe mundësive të barabarta

a. Evolucion i procesit ndëretnik dhe vendosja e KMNbve



b. Evolucion i barazisë gjinore dhe mundësive të barabarta dhe vendosja e Komisionit për mundësi të barabarta

Edhe pse ka shumë mënyra për bashkëpunim mes këtyre dy mekanizmave të disponueshme në nivel komunal, për fat të keq nuk ka dëshmi që një bashkëpunim i tillë është duke u zhvilluar në përgjithësi, as për çështjet që kanë të bëjnë me dialogun ndëretnik.

Për më tepër, Komisioni për mundësi të barabarta është i përbërë vetëm nga këshilltarët e zgjedhur si anëtarë të rregullt të Komisionit të cilat pengojnë pjesëmarrjen e plotë të përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile në punën e komisionit.

Sa i përket Komisionit për marrëdhënie mes komuniteteve, përbërja e komisioneve ekzistuese është e dominuar nga meshkujt. Kjo nënkupton se marrëdhëniet ndëretnike janë parë kryesisht përmes perspektivës së dominuar nga meshkujt.

Mekanizmi i tretë në dispozicion, jo direkt nën përgjegjësinë e qeverisë lokale, është Këshilli lokal për parandalim (KLP). Përshkrim i detajuar i këtij mekanizmi është dhënë në seksionin 3.2 të këtij raporti por duhet të theksohet se në mënyrë të ngjashme me bashkëpunimin e KMBO me KMB, asnjë nga këto dy mekanizma nuk kanë vendosur bashkëpunim me KLP në përgjithësi dhe në lidhje me çështjet e lidhur me parandalimin dhe sigurinë.

Organizatave të shoqërisë civile, në radhë të parë shoqatat qytetare të grave, paraqesin faktor të rëndësishëm që kontribuojnë në pjesë më të madhe deri më tani në implementimin e Rezolutës 1325. Në shumicën e rasteve, përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë më shumë njohuri për procesin dhe aktivitetet që kërkohen për agjendën për gratë, paqë dhe siguri në nivel lokal. Për fat të keq, për shkak të mungesës së kapaciteteve, ndërgjegjësimit dhe në një farë vullnetit politik, nuk ka pasur shkëmbime midis shoqërisë civile dhe mekanizmave të përpunuar më sipër. Nga ana tjetër, ata (së bashku dhe secili prej tyre) paraqesin pikë të vlefshme hyrëse për zbatimin e rezolutës në nivel lokal.

**Grafiku 2:** Mekanizmat dhe palët e interesuara për zbatimin e Agjendës për gratë, paqë dhe siguri në NJVL



## VII. Gratë refugjate në Maqedoni dhe sfidat që duhet të adresohen nga Rezoluta 1325<sup>13</sup>

Kryengritja paqësore siriane që filloi në mars të vitit 2011 është përkeqësuar në një konflikt brutal dhe të përgjakshëm mes regjimit të Asadit dhe një shumëllojshmërie të forcave opozitare me implikime rajonale. Konflikti ka qenë i shënuar si “një nga ekzoduset më të mëdha në historinë e kohëve të fundit”. Gratë dhe vajzat në veçanti janë prekur rëndë dhe negativisht nga ky konflikt. Si refugjatë, gratë dhe vajzat siriane kanë ikur dhe tani janë ballafaquar me një realitet të zymtë, dhe të ri ku problemet me të cilat ballafaqohen si femra janë rritur në mënyrë të konsiderueshme.

Nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2015 mbi 1.008.616 azilkërkues nga disa prej vendeve më të lartë në prodhimin e refugjatëve të botës, duke përfshirë Sirinë, Afganistanin dhe Irakun, e kanë bërë rrugën e tyre drejt Evropës Perëndimore nga deti. Nga këto, më shumë se 851,319 persona (duke përfshirë gra dhe fëmijë të cilët përbëjnë 17% dhe 25% të popullsisë së përgjithshme, kanë udhëtuar përmes Turqisë nga deti në Greqi, dhe në vazhdim me anë të Ballkanit Perëndimor me shpresë për të arritur në vendet në veri, përfshirë Austrinë, Gjermaninë dhe Suedinë. Shifrat totale të popullsisë besohet të jetë shumë më i lartë, pasi vetëm rreth 2 / 3 e azilkërkuesve janë duke u regjistruar me të arritur në vendet e tranzitit. Vetëm në vitin 2015, më shumë se 3,771 persona që janë duke e bërë këtë udhëtim të rrezikshëm kanë vdekur ose zhdukur në det. R. e Maqedonisë është korridori kryesor për njerëzit që udhëtojnë nga Greqia në Serbi.

Qeveria njofton se mbi 279.900 njerëz janë regjistruar qëllimin për të aplikuar për azil në vend nga 19 qershori deri në 24 nëntor 2015, edhe pse numrat reale vlerësohen të jenë pothuajse të dyfishtë. Pasi dokumentet e regjistrimit janë lëshuar, azilkërkuesit lejohen të hipin në trenat e qeverisë, apo autobusë private dhe taksi për të udhëtuar drejt veriut në drejtim të kufirit të Serbisë (një udhëtim 3-4 orë), ku ata kalojnë nëpër qendrën transit Tabanoc. Frekuenca e të ardhurve në Maqedoni në dhjetor ka rënë në 2,827, ka shumë të ngjarë për shkak të kushteve të kohës gjatë dimrit.

13 Прилагодено за целите на овој документ од Студијата на UN Women “Родова процена на кризата на бегалци и мигранти во Србија и Република Македонија” достапна на <http://www2.unwomen.org/~media/field%20office%20eca/attachments/publications/country/serbia/gender%20assessment%20of%20the%20refugee%20and%20migration%20crisis%20in%20serbia.pdf?v=1&d=20160112T163308>



Maqedonia është kryesisht vend transit përgjatë rrugës së Ballkanit Perëndimor, dhe prioriteti i azilkërkuesve është për të lëvizur nëpër territorin e saj sa më shpejt të jetë e mundur për të arritur vendet e destinacionit në Evropën Perëndimore. Popullsia e refugjatëve dhe migrante është jashtëzakonisht heterogjen, i përbërë nga individë me kombësi të ndryshme, gjuhë, kulturë, etnik, fe, gjini, mosha dhe nivele të ndjeshmërisë. Individët gjithashtu ndryshojnë shumë për sa i përket përbërjes së tyre në grup, statusit social-ekonomik, nivelet e arsimit, kapitalit shoqëror dhe arsyet e largimit nga vendi i tyre i origjinës.

Duke filluar në tetor të vitit 2015, punëtorët në vijën e parë raportuan ndryshime në trendet e popullatës prej një grupi të madh të burrave në numër të rritur të grave dhe fëmijëve, si dhe grupeve në nevojë, përfshirë të miturit e pashoqëruar dhe të ndarë, personat e moshuar, gratë shtatzënë, personat me aftësi të kufizuara dhe njerëzit me sëmundje kronike. Kjo pjesë e popullsisë gjithashtu duket të ketë më pak para, më pak burime dhe më pak informacion në lidhje me udhëtimin e tyre, duke rritur ndjeshmërinë e tyre ndaj shfrytëzimit dhe abuzimit. Deri në nëntor 2015, gratë dhe fëmijët përbënin deri në 42% të popullsisë së prekur (18% dhe 24% respektivisht) - një rritje mesatare prej 10% në përqindjen e femrave në krahasim me profilin në maj 2015. Profili i grave dhe vajzave pasqyron diversitetin e popullatës më të gjerë të prekur dhe përfshin gratë shtatzëna dhe ata që ushqejnë me gji (duke përfshirë gratë në fazat e vona të shtatzënisë), gratë e martuara (duke përfshirë gratë e dytë ose të tretë, si dhe vajza të martuara adoleshente), gratë e veja, gratë me aftësi të kufizuara, gratë e moshuara, vajzat adoleshente, vajzat më të rinj, të miturit e pashoqëruar femra, gratë e vetme, ndër të tjera.

Shumë nga këto gra udhëtojnë për t'u bashkuar me burrat e tyre të cilët janë tashmë në vendet e azilit. Të tjerët kanë lënë burrat e tyre prapa, duke supozuar se ata dhe fëmijët e tyre do të ketë gjasat më të lartë për një aplikim të suksesshëm për azil, dhe më pas që bashkëshorti i tyre të mund të ju bashkangjitet. Gratë mund të udhëtojnë vetëm me burrat e tyre (pa fëmijë ose një grup më të madh), ose të vetëm ose vetëm me fëmijët e tyre (pa burrë ose një grup më të madh), edhe pse këto shembuj në rastin e fundit janë të pakta.

#### **Rreziqet e identifikuar janë të shënuar më poshtë.**

##### Rreziqet e mbrojtjes:

Refugjatët dhe emigrantët gra dhe vajza përballen me sfida të veçanta dhe rreziqet e mbrojtjes në tranzit, duke përfshirë ndarjen e familjes, stresi psikosocial dhe trauma,

komplikime shëndetësore, veçanërisht për gratë shtatzëna, dëm fizik dhe lëndimet, dhe rreziqet e shfrytëzimit dhe dhunës në bazë gjinore. Shumë nga gratë po ikin konfliktit nga vendi i tyre sepse kanë vuajtur dhunën dhe shkelje ekstreme të drejtave, duke përfshirë bombardimet e rregullta të zonave civile, vrasje dhe zhdukje të anëtarëve të familjes, dhunë në bazë seksuale dhe gjinore (GBV), ndërprerje në qasjen në ushqim, ujë dhe energji elektrike dhe shkatërrim të shtëpive dhe jetesën e tyre. Disa janë zhvendosur në mënyrë të përsëritur ose janë shfrytëzuar apo keqpërdorur duke u përpjekur për të kërkuar azil. Gratë gjithashtu shërbejnë shpesh si kujdestaret kryesore për fëmijët dhe anëtarët e moshuar të familjes, duke thelluar më tej nevojën e tyre për mbrojtje dhe përkrahje.

Gratë dhe fëmijët (duke përfshirë të miturit e pashoqëruar) udhëtojnë pa familjarët meshkuj, të cilët varen nga kontrabandistë dhe kanë fonde të kufizuara, janë në rrezik në rritje të shfrytëzimit seksual ose trafikim.

Barrierat gjuhësore, faktorët kulturorë, si dhe qëllimi i azilkërkuesve për të lëvizur sa më shpejtë të jetë e mundur, mund të kufizojë aftësinë e grave dhe vajzave për të komunikuar me ofruesit e shërbimeve dhe kështu mund të parandalohen për të kërkuar mbrojtjen dhe ndihmën që u nevojitet. Mungesa e kohës dhe jetës private për të ndërtuar besimin me gratë, e kombinuar me një numër të kufizuar të personelit të trajnuar, dhe lëvizja e shpejtë e popullsisë, e bëjnë identifikimin e rastit, referimin dhe ofrimin e shërbimeve (duke përfshirë edhe sigurimin e vazhdueshëm të kujdesit nëpër vende të shumta përgjatë rrugës) shumë sfiduese.

#### **Aktivitetet humanitare:**

Në Maqedoni, përgjigjja kombëtare ndaj krizës është përshkruar në Planin e Reagimit të Qeverisë në rast të fluksit masiv të migrantëve (shtator 2015), i cili ka për qëllim të përshkruajë kapacitetet institucionale, materiale dhe administrative të shtetit për të reaguar në rast të një fluksi masiv i emigrantëve. Masat kryesore dhe aktivitetet e përshkruara në planin fokusohen në ruajtjen e sigurisë dhe të shëndetit publik, regjistrimin e emigrantëve, sigurimin e strehimit të përkohshëm, si dhe ndihmën humanitare dhe mjekësore, duke bërë të mundur kalimin e papenguar dhe të sigurtë të emigrantëve nëpër vend, dhe koordinimin e veprimeve në mes të institucioneve publike, organizatave humanitare dhe organizatave ndërkombëtare. Plani përmend asistencë të shënjestruar të nevojave për kategoritë e personave të rrezikuara, të përfshirë me ndihmë të posaçme në pika të përkohshme të kontrollit (duke përfshirë gratë shtatzëna, të miturit e pashoqëruar, personat me nevoja të

veçanta, etj) dhe mbrojtjen psikosociale për kategoritë e personave të rrezikuara në rast e qëndrimeve afatgjata.

Përderisa planifikimi i parasikuar qeveritar deri më tani është fokusuar në hardëare (për shembull, numrin e strehimoreve të përshtatura për dimër dhe shtretër të nevojshme) dhe jo në nevojën për shërbime (duke përfshirë mbrojtjen prej dhunës me bazë gjinore -GBV parandalimin dhe reagimin) në kushtet e qëndrimit afatgjatë, duhet theksuar se planet e emergjencës duhet të merret parasysh se planet duhet të konsiderojnë provizion të sigurimit të shërbimeve për të akomoduar dhe vendosur edhe ata me qëndrim më të gjatë, duke përfshirë shërbimet e mbrojtjes, dhe duhet të merr parasysh çdo mbështetje të nevojshme në situata të strehimit të grupeve të përziera / heterogjene të popullsisë gjatë periudhave të gjata kohore.

#### **Koordinimi:**

Koordinimi i të gjitha ministrive relevante për reagimin e përgjithshëm është drejtuar nga Qendra kombëtare për menaxhimin e krizave në pajtim me Ligjin për menaxhimin e krizave. Kontrolli kufitar dhe regjistrimi është nën përgjegjësinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa ndihma humanitare dhe kushtet e pranimit janë të koordinuar nga Ministria e Punës dhe politikës sociale (MoLSP), në bashkëpunim me UNHCR-në. Një grup pune ndërmintor mbikëqyr operacionet me mbështetjen e një organi operativ për menaxhimin e numrit gjithnjë në rritje të emigrantëve, të menaxhuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Koordinimi ndërmjet agjencive për reagimin ndaj krizave bëhet përmes Task forcës të OKB për Refugjatët dhe Migrantët të drejtuar nga UNHCR, i cili mbikëqyr koordinimin e një Grupi Punues për Mbrojtjen e Refugjatëve, bashkë-kryesohet nga MoLSP dhe UNHCR. Takime koordinuese javore mbahen në Gjevgjeli dhe Tabanoc me përfshirjen e deri më 35 aktorëve operativ (OKB, OJQ-të ndërkombëtare dhe OJQ-të lokale dhe autoritetet lokale), të kryesuar nga Qendra për menaxhim me kriza në bashkëpunim me UNHCR-në.

Kujdesi mbi gjininë femrore brenda kornizave të koordinimit të qeverisë është i kufizuar. Në nivel ministror, maqineritë kombëtare gjinore nuk marrin pjesë në organet ndërmintore të koordinimit dhe nuk janë aktive në përgjigje. Megjithatë ato mund dhe duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e një analizë gjinore në tryezë dhe se politikat përkatëse kombëtare dhe kornizat e planifikimit janë të ndjeshëm nga aspekti gjinor, duke përfshirë edhe përgjigje dhe plane të paparashikuara. Ato gjithashtu kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur si avokatë për gratë dhe vajzat në kontekstin e përgjigjes dhe potencialisht mund

të formojnë partneritete me homologët e tyre të makinerisë gjinore në vendet përgjatë rrugës transit.

#### **Regjistrimi:**

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është përgjegjëse për regjistrimin, dhe mbledhjen e të dhënave të ndara sipas moshës, vendit të origjinës dhe vulnerabilitetit. Mirëpo, procedurat e dobëta të regjistrimit dëshmojnë se të dhënat e nevojshme për të siguruar bazën për planifikim të saktë programor janë të kufizuar – duke inkuadruar të dhëna kritike mbi karakteristikat e popullsisë duke përfshirë edhe gjininë dhe ndarjen e moshës si dhe numrin dhe llojin e grupeve me nevoja të veçanta.

Përpjekjet e mbështetura nga OKB dhe BE- për të përmirësuar kapacitetin e MPB për të forcuar procedurat e regjistrimit janë në zhvillim e sipër. Kjo përfshin synimin për të siguruar që të gjithë azilkërkuarit janë të regjistruar, dhe se komponenta mbrojtëse e sistemit të regjistrimit duhet të forcohet, duke përfshirë kriteret standardizuese të cënueshmërisë, ndërtimin e kapaciteteve të stafit për të identifikuar dhe referuar grupeve të rrezikuara (duke përfshirë edhe viktimat e trafikimit), dhe harmonizimin e procedurave të regjistrimit në të gjithë rajonin, në mënyrë që të dhënat të jenë të krahasueshme dhe efikasiteti i regjistrimit të jetë i rritur.

#### **Pranimet dhe qendrat e transitit**

Qendra kryesore e pranimit është e vendosur në qytetin e Gjevgjelisë në kufirin me Greqinë, me qëllimin kryesor për të regjistruar azilkërkuarit, siguruar ndihmë urgjente, duke përfshirë strehim afatshkurtër, ujë, kanalizime, higjienë, ushqim, kujdes shëndetësor dhe mbrojtje - dhe lehtësimin e vazhdimin të udhëtimit të tyre drejt veriut ndaj Serbisë. Pjesën më të madhe të kohës azilkërkuarit e kalojnë në Gjevgjeli dhe janë jashtë qendrës së pranimit në pritje të procesimit të letrave të tyre të regjistrimit, gjë që mund të merr 1-6 orë në varësi të numrit të njerëzve që presin dhe komandantit të policisë. Jashtë qendrës ata nuk kanë qasje në shërbimet bazë, duke përfshirë objektet e strehimit, të ujit, sanitare dhe higjienike, artikuj joushqimorë, ushqim ose kujdes mjekësor. Gjatë errësirës nuk ka ndriçim jashtë qendrës, duke rritur rrezikun për gratë dhe vajzat.

Në Tabanoc përgjatë kufirit maqedono/serb, qendra për transit është ndërtuar rreth stacionit të trenit dhe shërben si një stacion për njerëzit që lëvizin për në Serbi - ku ata shpenzojnë mesatarisht 30 minuta (individët e ndjeshëm që vijnë natën vonë kanë mundësi të qëndrojnë gjatë natës në objektet afatshkurtra të akomodimit). Një gamë e shërbimeve

janë në dispozicion brenda qendrës (strehimore afatshkurtë, larje, shpërndarje të ndihmës joushqimore, ushqim, kujdes shëndetësor, mbrojtje) edhe pse ajo është shumë më e vogël se sa qendra në Gjevgjeli dhe shërbimet janë të mbushur me njerëz. Si me rastin e Gjevgjelisë, informacionet për rrugën dhe shenjat rreth shërbimeve të disponueshme nuk janë çdoherë të qarta.

#### **Uji, Kanalizimet dhe Higjiena:**

Objektet për ujë, kanalizim dhe higjienë në Gjevgjeli dhe Tabanoc janë bërë nga blloqe gjysmë të përhershëm sanitare të ndërtimit me tualete me qasje për të hendikepuar dhe të ndara në bazë të gjinisë, (në Gjevgjeli) dhe për të larë duart. Objektet janë të ndriçuar gjatë natës. Në Gjevgjeli, ka një stacion të veçantë për nënat dhe fëmijët në bllokun e kanalizimeve, të cilat mund të përdoren duke kërkuar një çels nga hapësira miqësore për fëmijëve, të krijuar nga UNICEF-i në afërsi.

Tualetet janë emërtuar veç e veç për gratë dhe burrat, por në Gjevgjeli mbishkrimet janë të dukshme vetëm nga pika të veçanta në qendër, dhe shumë azilkërkues nuk janë të vetëdijshëm se ku janë të vendosura tualetet, dhe burrat janë vërejtur gabimisht duke hyrë në bllokun femëror. Në Gjevgjeli, blloqet e grave për dush nuk kanë zonë private të thatë për tu veshur, dhe gratë duhet të përdorin hapësirën publike të bllokut të kanalizimeve për të ndërruar teshat. Në Gjevgjeli, tualetet janë në anën e kundërt të qendrës nga zona e zbakimit nga trenat, duke e bërë të vështirë për individët më pak të lëvizshëm të përdorin tualetet duke pritur në rradhë për tren. Nuk ekzistojnë tualet jashtë qendrës së pranimit në Gjevgjeli, ku qindra njerëz presin në radhë, nganjëherë për disa orë, për t'u regjistruar.

#### **Gjërat ushqimore dhe jo-ushqimore:**

Shumë aktorë (duke përfshirë organizatat vullnetare të cilët ishin në mesin e aktivistëve të parë që vepruan gjatë krizës) janë të përfshirë në prokurimin dhe shpërndarjen e artikujve ushqimorë dhe jo-ushqimorë. Shpërndarjen e ushqimit mund të ndryshojë nga ushqime të ngrohta deri në marendë dhe ujë. Për shkak të numrit të madh të grave dhe vajzave, artikujt joushqimorë kanë nevojë për rifurnizim të rregulltë, duke përfshirë: veshje të brendshme, streçe femrash, (për ngrohtësi dhe veshje heqje të lehtë), transportues për fosnje, si dhe xhupa dimri për gra dhe vajza, këpucë dhe veshje.

Faktorët kulturorë dhe kontekstual e formësuan modalitetin e shpërndarjes dhe përmbajtjen e artikujve joushqimorë. Në mënyrë të veçantë, punëtorët e vijës së parë kanë raportuar se në fillim të krizës, gratë nuk janë duke marrë peceta sanitare pavarësisht disponueshmërisë

së tyre. Diskutimet në fokus grupe me gratë zbuluan se ata nuk ndjehen rehat duke marrë peceta në publik, veçanërisht nëse punëtorët meshkuj të vijës së parë i shpërndajnë ato. Si rezultat, modalitetet më diskrete të shpërndarjes janë vënë në vend.

#### **Mbrojtja:**

Mbrojtja si përgjigje në Republikën e Maqedonisë është e përqëndruar në dhe rreth pikës kryesore të pranimit dhe qedrat e tranzitit dhe përfshin: vendosjen e ekipeve mbrojtëse mobile për të identifikuar grupet e ndjeshme; protokolet për ndjekjen e shpejtë të grupeve të rrezikuara; identifikimin e rasteve ndërkuftare dhe sistemin referues; sigurim të mbështetjes psiko-sociale dhe të kujdesit të specializuar përmes hapësirave miqësore për fëmijë dhe tenda për nëna dhe fëmijë; monitorimi i të drejtave dhe ndërgjegjësimi; ngritja e kapaciteteve të punonjësve të vijës së parë në identifikimin dhe referimin e grupeve në nevojë, duke përfshirë viktimat e trafikimit dhe të mbijetuarit e DHBGJ; mbështetje për fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë dhe për bashkim familjar.

Punëtorët social dhe stafi që punojnë në hapësira miqësore të fëmijëve raportuan se shpesh ata shohin fëmijët e shoqëruar nga nënat që kanë nevojë për mbështetje psiko-sociale, për shkak të stresit, lodhjes dhe traumë (për shkak të humbjes së një anëtari të familjes në det), por ata nuk janë në gjendje të japin vëmendje të individualizuar, pasi numri i stafit në krahasim me nevojën është i kufizuar dhe mandati i hapësirave është për të përcaktuar përparësitë për mbështetje të fëmijëve dhe fosnjave. Punëtorët e vijës së parë identifikuan në mënyrë të përsëritur mungesën e mbështetjes së shënjestruar psikosociale për gratë, si dhe mungesa e hapësirave vetëm për gra (ku gratë mund të pushojnë, të ndryshojnë rrobat e tyre, të heqin hixhabin e tyre, mund të kenë qasje në shërbimet mjekësore dhe të marrin mbështetje psikologjike), si një boshllëk të mbrojtjes kritike në përgjigjen e tanishme.

#### **Dhunë të bazuar në gjini(DHBGJ):**

Shërbime gjithëpërfshirëse për DHBGJ në kontekstin e gjërë të krizave dhe mbrojtjen nuk ekzistojnë në vend. Nuk ka ekspertizë dedikuar DHBGJ brenda stafit, nuk ekziston fokus sistematik tematik brenda reagimit të koordinuar për mbrojtje, dhe asnjë rrugë referimi nuk janë themeluar për DHBGJ në vendet përkatëse apo shtetet tranzit. Shumica e zyrtarëve të Qeverisë dhe të OKB-së mendonin se DHBGJ nuk është një çështje në kontekstin e krizës sepse nuk kishte raste të raportuar. Të tjerë mendonin se edhe në qoftë se incidente DHBGJ kanë ndodhur, natyra e krizës në vendet e tranzitit do të kufizojnë aftësinë e aktorëve të mbrojtjes për të identifikuar, referuar apo ofruar mbështetje substanciale për të mbijetuarit, dhe për këtë arsye sipas kësaj logjike, ishte pak që mund të bëhet. Aktorët për mbrojtje

njoftuan që në Maqedoni dhe Serbi, legjislacioni shtetëror, politikat, protokolet dhe rrugët referuese për DHBGJ janë të dobëta, si të tillë nuk mund të jetë në gjendje për të ofruar përpjekje gjithëpërfshirëse për të mbështetur azilkërkuesit që janë në rrezik të lartë ose azil kërkuesit në tranzit.

#### **Shëndeti:**

Kujdesi shëndetësor përfshin 24/7 prani të personelit mjekësor të Ministrisë së shëndetësisë dhe personelit të Kryqit të Kuq në qendrat e pranimit dhe për tranzit, të cilët punojnë ngushtë me përkthyes për të siguruar bazë mjekësore dhe për tu ofruar trajtimin e duhur shëndetësor. Shërbimet për gratë shtatzëna janë të kufizuara në të dy vendet, dhe shpesh herë gratë shtatzëna mund të vonojë trajtim shëndetësor në interes të arritjes në vendin e tyre të destinacionit në Evropën Perëndimore. Kjo ka çuar në disa raste të komplikimeve mjekësore, duke përfshirë aborteve. Përsa i përket shëndetit mental, shërbime të kufizuara të mbështetjes psiko-sociale ofrohen për gratë nëpër hapësirat miqësore për fëmijë dhe qendrat për nëna dhe foshnje. Ekziston nevoja për personel shtesë, për të siguruar mbështetje afatshkurtre psikosociale dhe këshillim për gratë në hapësire gjysmë-private vetëm për gra.

#### **Komunikimi dhe nevoja për informata:**

Në Maqedoni, azilkërkuesit kanë nevojë për qasje në informata të rëndësishme të përditësuara, për të ndihmuar ata të vazhdojnë udhëtimin e tyre, shpejtë dhe sigurtë. Shumica e burrave dhe disa gra duket se kanë telefona celularë dhe kështu mund të komunikojë lirshëm me miqtë dhe familjen. Qendrat e pritjes dhe tranzit kanë stacione për karikim të telefonave dhe Ëi-Fi pa pagesë, për të lehtësuar komunikimin midis azilkërkuesve, anëtarëve të familjes dhe miqve. Pavarësisht përpjekjeve të ndryshme, sigurimi i azilkërkuesve me informacion në lidhje me procedurat e regjistrimit si dhe për shërbimet në dispozicion në qendrat e pritjes dhe të tranzitit mbetet akoma një sfidë. Barrierat gjuhësore, si dhe faktorët kulturorë e kufizojnë aftësinë e shumicës së grave për të marrë informacione në mënyrë direkte (shumë shpesh mbështetet te burrat e tyre për informacion) dhe koj e kufizon dhe e vështirëson aftësinë për të komunikuar drejtpërdrejt me gratë.

#### **Media dhe komunitetet përkujdesëse:**

Palët e involvuar raportuan se ka pasur mbulim të kufizuar nga mediat për krizën me refugjatë dhe deklarata të kufizuara nga qeveria në mbështetje të refugjatëve, dhe më shumë vëmendjen i ka dhënë krizës politike në vend.

Reagimi i vullnetarëve lokale dhe OJQ-ve për mbështetjen e refugjatëve dhe emigrantëve ka qenë shumë i madh me mijëra individë që dhurojnë kohën dhe mjetet e tyre. Ata kanë luajtur një rol të rëndësishëm në sigurimin e mbështetjes për popullsinë në nevojë sidomos në ditët e para të krizës dhe gjatë përgjigjes së tanishme, duke përfshirë vende më pak të shërbyera. Në vend, OJQ-të janë duke punuar me organizatat për të drejtat dhe anti-ksenofobe për të ndërmarrë fushata mediale në mbështetje të tolerancës dhe pranimit të refugjatëve. Në kuadër të këtyre përpjekjeve, nuk është dhënë vëmendje e veçantë refugjatëve dhe emigrantëve gra dhe vajza.

#### **Sfidat e mbetura**

Sipas vlerësimit, deri më 42% e refugjatëve dhe emigrantëve janë gra dhe fëmijë. Planifikimi i reagimit, shërbimeve, kapacitetit mbrojtës dhe informacioneve ende nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e tyre dhe për të adresuar dobësitë e tyre të veçanta. Në mënyrë të veçantë, sistemet e regjistrimit nuk identifikojnë dhe referojnë në mënyrë adekuate në grupet në rrezik, dhe kanë lidhje të dobëta me veprimet e mbrojtjes. Vëmendja e përqëndruar në gjininë dhe GBV në kontekstin e menaxhimit më të gjerë dhe mekanizmat e koordinimit të OKB-së është i kufizuar me implikime negative për planifikimin dhe operacionet; kapaciteti i aktorëve humanitare të linjës së parë për të identifikuar dhe për t'iu përgjigjur çështjeve gjinore, DHBGJ dhe mbrojtur grupet e rrezikuar duhet të përforcohen, ashtu si edhe kapaciteti i shërbimeve sociale dhe organizatave lokale të grave për të marrë pjesë në mënyrë operacionale në veprimet e tyre humanitare;

Disa shërbime specifik sektoriale nuk kanë akoma dispozita adekuate në vend për të siguruar që gratë, vajzat, djemtë dhe burrat për dispozicion dhe qase të barabartë dhe përfitim nga ato dhe disa shërbimet urgjentisht të nevojshme për gratë dhe vajzat nuk ekzistojnë ose duhet të përmirësohen, duke përfshirë : monitorim të rritur të mbrojtjes, shërbime parandaluese dhe reagim ndaj DHBGJ, mbështetje të shënjestruar psikosociale dhe këshillime për trauma, hapësira vetëm për gra, dhe shërbime gjinekologjike në vend me orar të plotë në qendrat e pritjes dhe tranzitore.

Me lëvizjen e parashikuar të popullësisë për të vazhduar gjatë gjithë vitit 2016, është e rëndësishme që aktivitetet të rriten për të mbështetur më mirë sigurinë, dinjitetin dhe të drejtat e refugjatëve dhe të grave dhe vajzave emigrante, në përputhje me standardet ndërkombëtare humanitare dhe të drejtave njerëzore.

## VIII. Praktikrat e mira në zbatimin e Rezolutës 1325 nga vendet në rajonin e Ballkanit dhe në Evropë.

---

### 1. Zbatimi i Rezolutës 1325 në Bashkimin Evropian

Pika fillestare për zbatimin rajonal të Bashkimit Evropian të Rezolutës 1325 është qasje gjithëpërfshirëse e BE-së për zbatimin e Rezolutës 1325 dhe 1820 të KS të OKB. Kjo politikë mbulon tërë spektrin e instrumenteve të jashtëm të veprimit të BE-së në të gjithë vazhdimësinë e konfliktit, nga parandalimi i konfliktit deri te menaxhimi i krizës, ndërtimi i paqes, rindërtimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit. Ajo paraqet një “qasje të trefishtë” për zbatimin e Rezolutës 1325 të KS të OKB:

1. Për të integruar gratë, paqen dhe çështjet e sigurisë në dialogun politik dhe të politikave me qeveritë partnere, veçanërisht të vendeve të prekura nga konflikti i armatosur, në situata pas konfliktit ose situata të brishtë.
2. Për të inkuadruar një qasje barazie gjinore në politikat dhe aktivitetet e saj, veçanërisht në kontekstin e menaxhimit të krizave dhe në zhvillimin afatgjatë të bashkëpunimit të saj.
3. Për të mbështetur veprime specifike strategjike në sferën e mbrojtjes, mbështetjes dhe fuqizimit të grave

Ajo që është më e rëndësishme është se politika gjithëpërfshirëse angazhon BE në aspektin e jashtëm (mbështetjen e vendeve të treta në zhvillimin e PKV) dhe të brendshëm (sigurimin e forumit për shtetet anëtare të BE-së për të diskutuar praktikrat më të mira dhe interesat e përbashkëta në zbatimin e brendshëm të Rezolutës 1325). Treguesit për zbatimin e Politikës gjithëpërfshirëse u miratuan në vitin 2010, por treguesit mbeten mjaft të përgjithshme, pa referim të veçantë për subjektet përgjegjëse. Si pasojë, raportimi mbi performancën e reflekton këtë mangësi, në dokumentimin e iniciativave të ndërmarra në kuadër të secilit tregues në mënyrë të përgjithshme dhe jo-sistematike.

Ç’është më e rëndësishmja, megjithatë mbetet se treguesit përfshijnë një qasje të brendshme, duke u kërkuar vendeve anëtare të BE të raportojnë mbi punën e tyre individuale

në bazë të treguesve. Një “ Task Forcë për Gratë, Paqë dhe Siguri” joformal, i përbërë nga Sekretariati i Këshillit dhe shërbimet e Komisionit, si dhe pjesëmarrje e shteteve anëtare të BE-së, mbikëqyr Politikën gjithëpërfshirëse dhe zbatimin e tij.

## 2. Plani Kombëtar i veprimit i Irlandës për zbatimin e Rezolutës 1325

Plani Kombëtar i veprimit të Irlandës për zbatimin e Rezolutës 1325 (2011-2014) u lansua në nëntor 2011 nga Tánaiste dhe Ministri i punëve të jashtme dhe tregtisë, Eamon Gilmore TD, dhe ish-presidenti Mary Robinson. Plani kombëtar i veprimit (PKV) koordinon inputet e Irlandës në përpjekjet ndërkombëtare për zbatimin e Rezolutës 1325 dhe detyrimet e tjera të OKB-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.

PKV është hartuar duke u bazuar në konsultimet midis departamenteve dhe të shoqërisë civile dhe një nismë ndërkombëtare e përvojave të përbashkëta. Ai përcakton se si Irlanda do të promovojë dhe të zbatojë objektivat e Rezolutës 1325 në aktivitetet e program mbështetës, avokim diplomatik dhe përpilimin e politikave në të gjithë fushat e ndërlidhura të paqes, sigurisë dhe zhvillimit. Ai ka aplikim kombëtar pasi që përfshin dispozita që lidhen me gratë migrante dhe vajza azil-kërkuese në Irlandë. Ai gjithashtu pranon rëndësinë e Rezolutës 1325 dhe detyrimet e tjera të OKB-së mbi gratë, paqen dhe sigurinë në konfliktin në ishullin e Irlandës. PKV fokusohet në pesë shtylla, secili me një numër të objektivave, dhe përcakton veprime të qarta dhe afate kohore të targetuara. Ajo mund të shikohet në mënyrë të plotë në faqen e internetit DFAT në [www.dfa.ie](http://www.dfa.ie).

Pesë Shtyllat janë:

Shtylla 1: Parandalimi i konfliktit, duke përfshirë dhunën në baza gjinore (DHBGJ) dhe shfrytëzimi dhe abuzimi seksual (SHAS).

Shtylla 2: Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i grave në vendimmarrje.

Shtylla 3: Mbrojtja nga dhuna në baza gjinore (DHBGJ) dhe shfrytëzimi dhe abuzimi seksual dhe shkelje të tjera të të drejtave të njeriut të grave dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare.

Shtylla 4: Lehtësim, rimëkëmbje dhe rehabilitim.

Shtylla 5: Promovimi i Rezolutës 1325 në arenën ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare.

### Konteksti:

PNV të Irlandës është pjesë e një sërë politikash dhe strategjish kombëtare, vendase dhe të huaj për barazinë e grave dhe të drejtave të njeriut, më e fundit duke qenë politika e

zhvillimit ndërkombëtar e Irlandës One World, One Future. E propozuar si qasje “Mbarë qeveritare ndaj zhvillimit duke sjellur së bashku Divizionin politik dhe Divizionin për zhvillim të bashkëpunimit, e përforcon rëndësinë e koherencës në PKV të Irlandës.

Përderisa debatet në lidhje me vlerën e Rezolutës 1325, si një instrument të politikës që janë në vazhdim e sipër, nuk ka njohje të qartë të potencialit për PNV të ofrojë një mekanizëm të dobishëm për t’iu përgjigjur nevojave për mbrojtjen e grave, pjesëmarrjen dhe fuqizimin e tyre gjatë konfliktit. Ekspertiza në planin e veprimit për 1325 është në rritje, me disa Plane Kombëtare të Veprimit në fazën e dytë të zhvillimit. Sfidat janë të dukshme, për shembull në lidhjen e PNV të BE-së me njëri-tjetrin dhe për të qasjes gjithëpërfshirëse BE-së në Rezolutën 1325. Klima aktuale e kufizimit ekonomik paraqet një sfidë për të dhënë thellësinë dhe cilësinë e veprimeve pa patur nevojë për financim shtesë të rëndësishëm.

### Arritjet:

Ka pasur një nivel të lartë të aktivitetit në përparimin e objektivave nëpër Shtyllat e PNV me një numër të rëndësishëm të arritjeve. Zbatimi i angazhimeve në PKV ka sjellë së bashku një grup dukshëm më të ndryshëm të aktorëve me këndvështrime dhe nivele të ndryshme të angazhimit për agjendën për gratë, paqë dhe siguri. Një nga pikat e forta kryesore të PKV ka qenë që të sigurohet një pikë hyrje për departamentet dhe agjencitë për të ofruar një gamë të gjerë të veprimeve dhe për të ndërtuar dhe betonuar angazhimin për barazinë gjinore, DHBGJ dhe çështjet për fuqizimin e grave brenda dhe nëpër njësitë individuale dhe departamenteve dhe organizatave partnere.

Progresi në veprimet brenda shtyllave 1, 3 dhe 5 është i dukshëm, me disa rezultate të vlefshme dhe të rëndësishme për një numër të departamenteve kritike zbatuese dhe aktorëve. Fushat kryesore të suksesit kanë përfshirë punën për integrimin gjinor, mbrojtjen nga DhBGJ dhe avokimit në forumet e BE-së dhe OKB-së. Ndër arritjet në integrimin gjinor janë prodhimi i Planit të veprimit të forcave të mbrojtjes të Rezolutës 1325 dhe puna e Aid-it irlandez në forcimin e integritimit gjinor në programin e tij humanitar të veprimit. Sigurimin e parandalimit të konfliktit dhe mbrojtjen e shkeljeve të DHBGJ në konflikt formon një pjesë kritike të veprimeve të PKV dhe ka pasur veprim pozitiv në inkuadrimitin e standardeve të praktikës, sjelljes dhe përgjegjësisë për personelin në angazhimin e tyre jashtë shtetit në role paqeruajtëse dhe humanitare.

PNV ka mbështetur një gamë të gjerë të iniciativave për të forcuar mbrojtjen dhe pjesëmarrjen e grave, në veçanti në shtetet e prekura nga konflikti, nëpërmjet një programi të plotë të fondeve dhe përpjekjeve për të ndërtuar kapacitetin e organizatave qytetare

partnere, që të përqëndrohen direkt në tema specifike të Rezolutës. Shtylla 5 është një dimension i veçantë në kuadër të PKV që tregon një qasje strategjike për rritjen e levave dhe ndikimin e Irlandës brenda arenës ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare, si një kampion i barazisë së grave dhe të drejtave të njeriut. Një shumëllojshmëri e gjerë e aktorëve kanë treguar punën dinamike dhe inovative në zhvillimin e politikave, avokimin, diplomacinë dhe mbështetjen për institucionet kyçe, duke dhënë një gamë mbresëlënëse të rezultateve të cilat e kanë përforcuar më tej reputacionin e Irlandës si një avokat për të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.

#### Sfidat:

Një pyetje qendrore që del nga shqyrtimi është shkalla në të cilën veprimet për parandalimin dhe mbrojtjen mund t'i atribuohen në mënyrë specifike PNVsë, në krahasim me punën në vazhdim rreth angazhimeve në sferën e barazisë gjinore si rezultat i mekanizmave të tjerë. Për PNV, që të sjellë vlerën e shtuar, nevojitet një identifikim më i qartë i veprimeve specifike të PNV nëpër të gjitha departamentet dhe agjencitë.

Pjesëmarrja e grave në ndërtimin dhe ruajtjen e paqes është thelbësisht e lidhur me trajtimin e shkaqeve dhe strukturave të konfliktit dhe është e nevojshme më shumë progres në të gjitha departamentet dhe agjencitë e PKV për përmirësimin e pozitës së gruas në nivele strategjike dhe të politikave. Në forumet ndërkombëtare, angazhimi i grave në ndërmjetësimin e procesit të konfliktit dhe paqes është ende në realizim e sipër, por me potencial për të bërë një ndryshim. Më shumë prova janë të nevojshme për ndikimin që ndërhyrjet kanë bërë në teren, së bashku me konsultime të rregullta me gratë në komunitetet lokale për të vlerësuar shkallën deri ku aktivitetet paqeruajtëse, zhvillimore dhe humanitare i përmbushin këta nevoja. Vëmendje më e madhe është e nevojshme për të zgjeruar fokusin e tanishëm të PKV-së në kuadër të shtyllave të ndihmës, shërimit dhe rehabilitimit që shkpjnë më tej se çarmatimi, çmobilizimi dhe reformimi i sektorit të sigurisë për të pasqyruar shkallën e plotë të programeve humanitare dhe të zhvillimit të AID të Irlandës në konflikt dhe në rindërtimin pas konfliktit.

PNV i Irlandës ka dimension të brendshëm dhe të jashtëm unik. Jashtë shtetit dhe në arenën ndërkombëtare është ku PKV-ja ka qenë më e dobishme në marrjen e masave për të sjellë ndryshime konkrete në jetën e grave dhe vajzave. Më pak progres është evident në zbatimin e veprimeve brenda Irlandës, në Irlandën veriore për gratë nga vendet e prekura nga konflikti që jetojnë në Irlandë dhe grave në Irlandën e Veriut. Vëmendje më e madhe është e nevojshme për të ofruar veprimeve aktuale dhe për të zgjeruar gamën e veprimeve për këto gra nëpër të gjitha shtyllat.

Ndër sfidat kryesore në matjen e progresit në zbatimin e PKV-së është edhe mungesa e të dhënave bazë në lidhje me objektivat, veprimet dhe treguesit. Ka pasur mospërputhje në nivelin dhe natyrën e të dhënave të monitorimit, mungesë të të dhënave sasiorë dhe cilësore, duke përfshirë informacione mbi shpenzimet financiare dhe në shumë raste, të dhëna të kufizuara në lidhje me tregues të veçantë. Kjo lidhet me të metat në kornizën e përgjithshme të monitorimit me dobësi në marrëdhëniet mes objektivave, veprimeve, treguesve dhe indikatorëve dhe veprimeve të cilat janë jorealitike ose tepër të ngushtë për të përfshirë atë që duhet bërë. PNV do të përfitojë nga kalimi nga qasja e saj aktuale disi burokratike ku ka një përqendrim joproporcional në treguesit sasiorë të veprimeve të cilat mbështesin ndikimin dhe kontribuojnë në ndryshimin edhe më të madh. Kjo mund të arrihet duke pasqyruar më saktë sasinë e rëndësishme të punës që departamentet aktualisht mund të japin, si dhe identifikimin e prioriteteve për punën në të ardhmen.

Sfidat ishin gjithashtu të dukshme në rolet udhëheqëse dhe koordinative për një departament drejtues me përgjegjësi për zbatimin e PKV, dhe qartësi më e madhe dhe forcimi i roleve është i nevojshëm për të udhëhequr PKV dhe për të koordinuar, mbikëqyruar dhe monitoruar zbatimin e PKV-së nëpër gjithë departamentet dhe agjencitë. Qartësia e roleve është e nevojshme edhe në kuadër të Grupit të monitorimit në lidhje me përgjegjësinë për nxitjen e ndërgjegjësimit të PKV dhe Rezolutës 1325 të KS të OKB. Përforcimi i komunikimit brenda grupit do të mbështesë të kuptuarit më të madh dhe të ndërtuarit të bashkëpunimit mes përfaqësuesve. PNV i Irlandës është një dokument “i gjallë”, i cili është pjesë e një procesi në zhvillim për të ndërtuar një qasje transformuese për të bërë të mundur që gratë të jenë pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e paqes dhe parandalimin e konflikteve.

### 3. Plani i Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 i Bosnjës dhe Hercegovinës

Miratimi i Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 në Bosnjë dhe Hercegovinë në vitin 2010 ishte një moment i rëndësishëm për promovimin e barazisë gjinore dhe të sigurisë në Bosnje. Plani i Veprimit (PV) i referohet periudhës mes korrikut 2010 dhe korrikut të 2013. Zbatimi i PV përtej kësaj periudhe do të varet nga vlerësimi i Agjencisë për barazi gjinore të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Këshillit Koordinues.

Pika fillestare për hartimin e PV ishte Raporti i monitorimit mbi zbatimin e Rezolutës 1325 të KS në Bosnjë dhe Hercegovinë (Gratë për Gratë dhe UNIFEM, 2007). Procesi i hartimit të PV është koordinuar nga Agjencia për Barazi Gjinore, në bashkëpunim me grupin punues për përgatitjen e PV për zbatimin e Rezolutës 1325 në Bosnjë dhe Hercegovinë. Grupi punues u përbë nga

përfaqësues të këtyre institucioneve: Ministrisë së Sigurisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Financave dhe Thesarit, Qendrës gjinore të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Qendra gjinore e Republika Srpska, Ministria Federale e Punëve të Brendshme, Policia Federale, Ministria e Brendshme e RS, Qendra e Veprimit ndaj Minave të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe një përfaqësues i Grave të shoqatave të Grave.

AP u miratua në korrik të vitit 2010 dhe paraqet një dokument gjithëpërfshirës strategjik për integrimin gjinor në sektorin e sigurisë. Dokumenti përfshin një periudhë tre vjeçare, nga korriku 2010 deri në korrik 2013. Në korrik të vitit 2013, zbatimi i PV do të vlerësohet nga Agjencia për Barazi Gjinore të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe nga Bordi Koordinues, duke përfshirë një vlerësim të objektivave të përcaktuara, aktiviteteve, angazhimeve, palëve të involvuar dhe treguesve të arritjeve/jo-arritjeve. Pas kësaj, një plan i ri veprimi do të zhvillohet.

PV përcakton një numër të detyrave që duhet të përfundojë deri në korrik 2013. Qeveria nacionale dhe agjencitë e saj, mekanizmat institucional, komitetet, shoqatat qytetare dhe organizatat ndërkombëtare janë bashkërisht përgjegjës për të gjitha aktivitetet e palëve të interesuara, dhe një numër të madh të treguesve për vlerësimin e progresit, si dhe burimet financiare për arritjen e tetë (8) qëllimeve.

Burimet financiare për zbatimin e PV janë marrë pjesërisht nga buxheti i institucioneve të autorizuar, dhe pjesërisht nga fondet e programit FIGAP. Deri më tani, Agjencia e Bosnjës dhe Hercegovinës për barazi gjinore ka paraqitur dy raporte deri te Këshilli i Ministrave për zbatimin e PV, të cilat ishin të miratuar nga Dhoma e Përfaqësuesve të Asamblesë Parlamentare të Bosnjës dhe Hercegovinës.

Mekanizmi bazë për monitorimin e zbatimit të PV është Bordi koordinues, i cili është i përbërë nga personeli nga sektori i sigurisë dhe institucionet e saj anëtarë dhe një anëtar që përfaqëson shoqërinë civile. Bordi Koordinues u emërua me kohëzgjatje sa edhe i Planit të veprimit. Qasja proaktive e Këshillit Koordinues në monitorimin e zbatimit të PV është njohur në Bosnjës dhe Hercegovinës dhe në rajon, si një shembull i praktikës së mirë.

*Arritjet kryesore dhe sfidat në zbatimin e PV 1325*

### **Përfshirja e grave në vendim-marrje**

Trashëgimia e luftës dhe kriza ekonomike vazhdon të minojë pjesëmarrjen e grave në jetën publike. Pabarazia gjinore është e dukshme në të gjithë sektorët e jetës publike. Vetëm një rreth 5-7% të pozicioneve ekzekutive mbahen nga gratë në nivel lokal, ndërkohë që asnjë grua nuk mban një pozicion ekzekutiv në nivel nacional. Edhe pse një sistem i kuotës dhe

mekanizmat e integritit të gjinive kanë rritur pjesëmarrjen e grave në jetën politike të përgjithshme, numri aktual i grave udhëheqëse dhe vendimmarrëse në zonat ekzekutive në të gjitha nivelet e qeverisë nuk është rritur.

Natyrë e dobët e politikës në Bosnjë dhe Hercegovinë nën administrimin ndërkombëtar do të thotë se gjinia është një fokus më pak e rëndësishme se sa zgjidhjen e çështjeve të tilla si nacionalizmi me bazë etnik, varfëria dhe papunësia. Problemi është se programet për ndërgjegjësim në lidhje me rëndësinë e pjesëmarrjes së femrave nuk janë zbatuar në mënyrë sistemore ose të vazhdueshme, por paraqesin veprime ad hoc duke u zhvilluar vetëm dy ose tre muaj para zgjedhjeve. Një qasje e tillë nuk kontribuon në kuptimin e perspektivës gjinore në fuqizimin e grave dhe pjesëmarrjen qytetare.

### **Perspektiva gjinore në sektorin e sigurisë**

Trajnimi gjinor i policisë, gjyqtarëve, prokurorëve, zyrtarëve të kujdesit shëndetësor dhe mësuesve është përcaktuar me Planin nacional për veprim gjinor, por ofrimi i programeve mbështetëse në bashkëpunimin e ngushtë mes aktorëve qeveritarë dhe të shoqërisë civile. Mungesa e referencës ndaj gjinisë në reformat e policisë tregon vëmendjen e pakët që merr gjatë trajnimeve aktuale të policisë, dhe trajtimin e shqetësimeve specifike gjinore nga ana e policisë lokale dhe trajtimi i grave mbetet i çrregullt dhe i pabarabartë. Forcat ndërkombëtare të mbrojtjes që veprojnë në Bosnjë dhe Hercegovinë janë të qeverisura rregulluara me urdhër të shtetit të tyre, dhe ka variacion të gjerë në nivelin e trajnimit që anëtarët e këtyre forcave kanë marrë mbi çështjet gjinore.

Selia e NATO-s në Sarajevë dhe MM kanë kryer aktivitete të përbashkëta për të nxitur dhe për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e Rezolutës 1325. Rreth 3000 pjesëtarë të Ministrisë së mbrojtjes dhe të forcave të armatosura të Bosnjës dhe Hercegovinës morën pjesë në trajnim. Agjencia për barazi gjinore, në bashkëpunim me qendrat e entitetit gjinor, agjencitë për shërbyesit civil dhe misioni policor i Bashkimit Europian (MPBE), ndërmorrën trajnime për përfaqësuesit e Ministrisë për punë të brendshme, forcat e policisë dhe nëpunësit civilë.

### **Të drejtat e njeriut të grave dhe vajzave**

Një dukuri e shpeshtë e dhunës në familje dhe trafikimit me qenie njerëzore në ambientin pas konfliktit në Bosnjë dhe Hercegovinë, bën thirrje për vëmendje të vazhdueshme në këto çështje. Përderisa, shoqatat qytetare gjërisht raportojnë mbi incidentet e dhunës ndaj grave, ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje nuk është plotësisht i integruar në



legjislacionin tjetër penal dhe ende nuk është zbatuar tërësisht. Trafikimi i grave dhe vajzave është një tjetër sulm ndaj të drejtave të grave në Bosnjë dhe Hercegovinë. Prevalenca e diskriminimit ndaj grave, papunësisë, varfërisë dhe problemeve të pazgjidhur të zhvendosjes së një numri të madh të njerëzve vazhdojnë të përkeqësojnë gjasat e trafikimit me njerëz. Veprimet e shtetit dhe të OKB-së për të luftuar trafikimin në Bosnjë dhe Hercegovinë kanë qenë të papërshtatshme.

#### *Vlerësimi i ndikimit të Planit të veprimit*

Pavarësisht nga disa praktika të suksesshme, ka ende probleme të cilat nuk janë identifikuar në PV. Së pari, ngacmimi seksual dhe diskriminimi në bazë gjinore në institucionet e sigurisë janë “të padukshme” apo ngjarje, “jo-ekzistente” ose përvoja të cilat nuk janë folur publikisht. Ngacmimi seksual dhe diskriminimi me bazë gjinore vështirë se është raportuar ndonjëherë, ndoshta për shkak të një kombinimi të disa faktorëve, duke përfshirë ngacmimet seksuale duke qenë të papranueshme, viktimat e ngacmimeve të frikësuar për të raportuar atë dhe vetë fakti se vetëm disa institucione kanë vënë në vend mekanizmat dhe politikat institucionale për të mundësuar raportimin.

#### **Tekst në kuti 4: Shembuj të praktikave të mira në zbatimin e AP-së në BiH**

*Agjencia për barazi gjinore dhe Qendrat pwr entitete paraqitwn propozime për ndryshime të ligjeve të shtetit dhe njërive në sferwn e oficerëve të policisë në pajtim me Ligjin për barazi gjinore nw Bosnjw dhe Hercegovinw, i cili është një parakusht për pjesëmarrje të rritur të grave në forcat e policisë dhe në vendim-marrje.*

*Ministria e sigurisë sw Bosnjws dheHercegovinws wshtw duke zbatuar masa pozitive për të inkurajuar gratë që të aplikojë për të marrë pjesë në misionet paqeruajtëse. Ata kanë ulur kriteret e përgjithshme nw përvojën e punws prej 8 deri në 5 vjet për gratë, ndërsa kusht për meshkujt mbetet 8 vjet pwrvojw nw shërbim, qw do të çojë në rritje të përqindjes sw tanishme të 14.29% të grave në misionet paqeruajtëse.*

*Ministria për të drejtat e njeriut dhe refugjatët është duke udhëhequr*

*Strategjinë për zhvillimin e procesit për përmirësimin e të drejtave të grave viktimat të abuzuara gjatë luftës.*

Nisma të tilla si Rrjeti i zyrtarëve të grave policë në nivel rajonal, rrjeti i grave në Ministrinë e punëve të brendshme të Republika Srpska, rrjeti i grave policë të Federatës së Bosnjë dhe shoqatës së gratë gjyqtarë të Bosnjës dhe Hercegovinës mundësisht mund të nisë diskutimin mbi çështje që lidhen me zbatimin e PV.

Sipas kornizës së rrjetit të zyrtarëve gra policë, dy shoqata të grave police kanë themeluar: rrjetin e grave të policisë në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe rrjetin e shoqatave në Ministrinë e punëve të Republika Srpska. Këto dy shoqata punojnë në nivelin e lokal dhe synojnë të promovojnë barazinë gjinore përmes një qasje strategjike për arsim, punësim, trajnim dhe zhvillim të karrierës së grave në polici, si dhe duke njoftuar rezultatet e arritura nga personeli femra të shërbimeve të policisë.

Partnerë të rëndësishëm për institucionet përkatëse në implementimin e Planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 në Bosnjë dhe Hercegovinë (2010-2013) janë organizatat ndërkombëtare aktive në këtë fushë, si: OKB Gratë (UN Women), Shtabi i NATO-s në Bosnjë dhe Hercegovinë, UNDP dhe OSBE. UN Women do të vazhdojë të mbështesë projektet e organizatave të shoqërisë civile në bashkëpunim me mekanizmat institucionale dhe institucionet qeveritare.

Anëtarët e Bordit koordinues kanë marrë pjesë në mënyrë aktive dhe kanë kontribuar në promovimin dhe implementimin e PV, si brenda institucioneve nga të cilat ata vijnë, poashtu edhe në mesin e publikut të gjerë dhe në nivel ndërkombëtar. Të gjitha proceset në Bosnjë dhe Hercegovinë të cilat kanë të bëjnë me Rezolutën 1325 janë pjesë e bashkëpunimit rajonal në të gjitha nivelet dhe do të vazhdojë të jetë kështu edhe në të ardhmen.

## Bibliografia dhe Referencat

1. “Women, Peace and Security in the Western Balkans : Independent review of translation of UNSCR 1325 into the policies in Albania, Bosnia and Herzegovina, Kosovo, Macedonia and Serbia. Belgrade Centre for Security Policy”, 2013  
[http://www.bezbednost.org/upload/document/assessment\\_report\\_%5Bweb%5D.pdf](http://www.bezbednost.org/upload/document/assessment_report_%5Bweb%5D.pdf)
2. “Report On The status of Implementation Of UNSC Resolution 1325 in the Western Balkans” Publisher: Helsinki Committee for Human Rights in Serbia  
<http://www.helsinki.org.rs/doc/Files31.pdf>
3. “Community Policing Model in Skopje - from idea to reality”, publisher Analytica think tank, Selimi, Bogatinovski , Skopje 2015  
[http://www.analyticamk.org/images/news/2015/11/Analitika\\_Web\\_Ang\\_f8c10.pdf](http://www.analyticamk.org/images/news/2015/11/Analitika_Web_Ang_f8c10.pdf)
4. “OSCE Study on National Action Plans on the Implementation of the United Nations Security Council Resolution 1325”. Author: Christin Ormhaug, Peace Research Institute Oslo (PRIO). Vienna, September 2014  
<http://www.osce.org/secretariat/125727?download=true>
5. “Preventing Conflict Transforming Justice Securing the Peace- A Global Study on the Implementation of United Nations Security Council resolution 1325”. UN Women, 2015  
<http://wps.unwomen.org/~media/files/un%20women/wps/highlights/unw-global-study-1325-2015.pdf>
6. “Results of a Participatory Assessment - National and Local Capacities for Strengthening Inter-Ethnic Dialogue and Collaboration”, Prepared by UNDP as part of the UN Programme to Enhance Inter-Ethnic Dialogue and Collaboration, September 2010  
[http://www.mdgfund.org/sites/default/files/UNDP\\_Participatory\\_Report\\_Full\\_English.pdf](http://www.mdgfund.org/sites/default/files/UNDP_Participatory_Report_Full_English.pdf)

## Bibliografia dhe Referencat

7. “The Ohrid Framework Agreement Negotiations”, Advanced Research and Assessment Group (ARAG), Vasko Popetrevski, Veton Latifi, 2004  
<http://www.isn.ethz.ch/Digital-Library/Publications/Detail/?lang=en&id=44466>
8. “Are We Listening? Acting on Our Commitments to Women and Girls Affected by the Syrian Conflict”, International Rescue Committee, September 2014  
[https://www.rescue.org/sites/default/files/resource-file/IRC\\_WomenInSyria\\_Report\\_WEB.pdf](https://www.rescue.org/sites/default/files/resource-file/IRC_WomenInSyria_Report_WEB.pdf)
9. “Gender Assessment of the Refugee and Migration Crisis in Serbia and FYR Macedonia”, Europe and Central Asia Regional Office, UN Women, Istanbul Turkey, January 2016  
<http://www2.unwomen.org/~media/field%20office%20eca/attachments/publications/country/serbia/gender%20assessment%20of%20the%20refugee%20and%20migration%20crisis%20in%20serbia.pdf?v=1&d=20160112T163308>
10. “Mid-Term Progress Report Implementation of Ireland’s National Action Plan for UNSCR 1325, 2011 – 2014” Hinds an McMinn,  
<https://www.dfa.ie/media/dfa/alldfawebstimedia/ourrolesandpolicies/int-priorities/Progress-Report-UNSCR-1325.pdf>

## Aneks 2 Plani nacional për veprim i Republikës së Maqedonisë 2013-2015 për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurisë së OKB.

Qëllimi strategjik 2: Pjesëmarrja dhe kontributi i përforcuar i grave në misionet ndërkombëtare civile dhe ushtarake në të cilët merr pjesë Republika e Maqedonisë			
Rezultat	Aktivitet	Indikatorë	kohore
2.1 Kapacitete të ngritura të të punësuarve në institucione (gra dhe burra) në lidhje me aspektet gjinore të MPSS të Republikës së Maqedonisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Trajnimi i trajnuesve (TOT) – Trajnim për persona nga institucionet relevante</li> <li>Formimin e bazës së ekspertëve për Rezolutën 1324 të Agjendës për gra, paqë dhe siguri)</li> <li>Krijim të programit për trajnim për Rezolutën 1325, Agjendën, dhunën e bazuar në gjini (nga personat që do të trajnojnë për)</li> <li>Azhurimi i kurseve për trajnime për profesional (ekspertë ushtarakë dhe civil) të dërguar në misione për ruajtjen e paqës me informata për çështje gjinore, Rezolutën 1325, dhunën e bazuar në gjini;</li> <li>Shkëmbim të përvojave dhe praktikave më të mira mes trajnuesve (bazë ekspertësh për Rezolutën 1325 për çështje të gjinisë) nga vendet në rajon dhe më gjërë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Lloji dhe madhësia e programit dhe doracakët për trajnim për Rezolutën 1325, Agjenda për gra, paqë dhe siguri, dhe dhunën e lidhur me gjini;</li> <li>Trajnime të mbaruara dhe numri i trajnimeve të sertifikuara në sektor</li> <li>Numri i trajnimeve të mbaruara për personelin e lartë dhe të mesëm</li> <li>Pjesëmarrja e ekspertëve dhe trajnuesve për aspektet gjinore në bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar;</li> <li>Inkuadrimi i ekspertëve dhe i trajnuesve për aspektet gjinore dhe bashkëpunim ndërkombëtar.</li> </ul>	2013-2015  Në përputhshmëri me planet operative vjetore për barazi të gjinive të Ministrisë për punë dhe politikë sociale.

2.2 Roli dhe funksioni i përforcuar i mekanizmit/institucioneve për dërgimin e grave në misione ndërkombëtare	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pranimin e instrukcioneve dhe akteve të brendshme të drejtuara kah krijimi dhe udhëzimi më efikas të pjesëmarrjes së grave në misione të grave ( si për shembull kriteret për punë të Komitetit ndër-institucional për referimin e profesionalëve në misione, afate të shkurtuara për sjellje të vendimeve. Sipas normave dhe procedurave nacionale sipas marrëveshjeve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Instrukcionet e sygjera dhe të pranuar dhe rregullativat e brendshme për referimin e grave në misione</li> <li>Shkalla e harmonizimit të ligjeve vendore me ato ndërkombëtare në drejtim të referimit të profesionalëve në misionet ndërkombëtare.</li> </ul>	2013-2015  Në përputhshmëri me planet operative vjetore për barazi të gjinive të Ministrisë për punë dhe politikë sociale.
2.3 Prezenca më e madhe e grave diplomat në pozitë e larta në misionet diplomatike dhe konzulare dhe vendosja e pozitës së këshilltarit për çështje gjinore në misione paqëruajtëse në të cilët merr pjesë Maqedonia.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pranimi i aktit të brendshëm për përfaqësim proporcional të grave në Komitetin për referim të profesionalëve në misionet diplomatike dhe konzulare (30%) ;</li> <li>Pranimi i aktit të brendshëm për emërim të këshilltarëve për çështje gjinore në misionet paqëruajtëse në Ministrinë për punë të jashtme</li> <li>Vendosje të mekanizmit për ndërmjetësim sensitiv gjinor dhe dialog në nivel shtetëror dhe rajonal</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritje prej 30% të numrit të grave anëtarë të Komitetit për referim si rezultat i aktit të brendshëm;</li> <li>Rritje për 10% të numrit të grave të cilët janë të nominuar për referim</li> <li>Mekanizëm i vendosur për ndërmjetësim sensitiv gjinor</li> <li>numri i grave ndërmjetësuese</li> <li>iniciativa të sygjera dhe të zbatuara për ndërmjetësim (formale dhe joformale) me gra ndërmjetësuese</li> </ul>	2013-2015  Në përputhshmëri me planet operative vjetore për barazi të gjinive të Ministrisë për punë dhe politikë sociale.
<p><b>Indikatorë për qëllimin strategjik 2: Numri i grave të nominuara dhe të miratuara për pjesëmarrje në misione civile dhe ushtarake në të cilët merr pjesë Republika e Maqedonisë, i rritur për 10% në secilën fushë deri në vitin 2015</b></p> <p>Ministria për punë dhe politikë sociale, në bashkëpunim me Ministrinë e punëve të jashtme, Ministrinë për mbrojtje, Ministrinë për punë të brendshme, Drejtorinë për mbrojtje dhe shpëtim, Ministrinë e shëndetësisë, qendrën për menaxhim me kriza, sektorin civil, pushtetin lokal, qendrën për trajnim dhe Akademinë për diplomacy, institucione akademike, Komisionin për referim të profesionalëve në misione diplomatike dhe konzulare, komisionin ndër-ministor për referim të profesionalëve në organizata ndërkombëtare</p>			

